



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



**01 Nr. 11/24**  
**Rahovec, 13.11.2024**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **njëmbëdhjetë (11)**, e cila do të mbahet më **22 nëntor 2024 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarje të parcelave në ZK- Kramovik P- 00760-1 dhe ZK Petkoviq (Gur i Kuq) P-00185-0, 01122-0, 01124-1 dhe 01124-2;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 00268-1 ZK-Hoçë e Madhe;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00268-1 ZK Hoçë e Madhe;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.253/24, i datës 24.9.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës dhe vendimin 01 Nr.254/24, të datës 24.9.2024, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;
8. Shqyrtimi i informatës për punët e bujqve të komunës së Rahoveci.

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
  
**Arbër Zenuni**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNES / MUNICIPALITY OF RAHOVEC  
OPŠTINA RAHOVAC



Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.10.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi që kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 25.

**Kryesuesi:** Përhëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar i Komunës, **Smajl Latifi**, nënkryetar **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **dhjetë** me radhë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, 2024-2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2024-2028;
5. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar-shtator 2024;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, P-00772-10, ZK- Xërxë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës 05537-2, ZK- Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe të Komunës së Rahovecit;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Ratkoc të Komunës së Rahovecit;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë të Komunës së Rahovecit;
11. Shqyrtimi i informatës nga DMSH-ja, lidhur me situatën e zjarreve gjatë sezonit të verës.

### Shtesë:

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim- vendimin për transferimin (harmonizimin) e mjeteve buxhetore 2024.

**Kryesuesi:** Të nderuar kuvendarë, fillimisht e kemi edhe një pikë shtesë të cilën do ta prezantojë drejtori i Financave, Afrim Limani.

**Afrim Limani:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, sot e kemi si pikë shtesë vendimin për transferimin dhe harmonizimin e mjeteve në kuadër të kategorisë: Paga dhe Shtesa për vitin 2024. Në vendim për transferim kërkohen 482.735.20€.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Atëherë, pikën shtesë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë unanime (20) aprovet pika shtesë. Tani e vendosim në votim rendin e ditës si të tillë. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimitisht (22) votohet rendi i ditës i paraparë për mbledhjen e dhjetë të Kuvendit Komunal.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A kemi ndonjë koment apo diskutim nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimitisht aprovet pika e parë e rendit të ditës.

### **2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegët asambleistë, monitoruesit, mediet! Pyetje të reja nuk kam, përpos asaj që dua t’i përsëris dy pyetje prej të cilave nuk kam marrë përgjigje. Një pyetje ka qenë para dy seancave, sa është vlera që komuna gjendet në procedurë gjyqësore-përmbartimore që pritet t’i merren komunës. Sa është vlera bazë dhe shpenzimet e tjera – kamata? Pyetja tjetër ka të bëjë me tri projektet që i ka evidentuar ZKA-ja, që kompanitë i kanë përfituar projektet përmes 20%-it të poenëve, si rezultat i planit dinamik. Pyetja ka qenë: Këto kompani a kanë qenë më të lirta? Apo 20%-shi u ka mundur që ta marrin projektin? Faleminderit, është pyetje e përsëritur e seancës së muajit gusht.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, të pranishëm në sallë! Kryetar, këtë muaj jeni takuar me Liburn Aliun për çështjen e zgjerimit të rrugës, Gjakovë – Rahovec – Prizren. Çështja analoge me autostradën e Dukagjinit dikur. Fillimisht, unë nuk kam besim te ju e as te Liburn Aliu në këtë valle 6-vjeçare. Kemi informata, por edhe në postimin tuaj në projektor, figuron varianti I final. Në atë plan të parë, para Urës së Fshajit, ndërrohet kahja e rrugës tërësisht. Rruga kryesore e Xërxës, që është në lidhje në mes të Prizrenit dhe të Gjakovës, si dhe vazhdimisht është në rritje me biznese afër rrugës, po izolohet. Me këtë izolim, komuna jonë izolohet në tërësi. Unë nuk e di me kë ka bërë pazare Liburn Aliu, veç e di që ai ka thënë që autostradë nuk ka, por vetëm zgjerim të rrugës aktuale. Po them me bindje të plotë që çdo ndryshim i kahës së rrugës aktuale për zgjerim, është akt pabesie ndaj të gjithë banorëve të Rahovecit dhe izolim i pashembullt i një komune të Kosovës. Kryetar, ju jeni pjesë e këtij diskutimi dhe do të jeni përgjegjës nëse kjo ndodh në Rahovec. Mos të harrojmë, në krejt këto vite, në 70% të territorit është shpërfillur në tërësi Rahoveci. Neve si potencial biznesor dhe jo vetëm, na ka mbetur Xërxa, e cila shërben si vend tranzit për këto komuna. Po e shtroj këtë çështje në kuvend që të marrim sqarime prej kryetarit dhe të diskutojmë për ndalimin e negociatave të dikujt atje lart, apo të dikujt këtu poshtë, në kurriz të Rahovecit.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë, vëzhgues! Kur e kemi votuar në fillim planin e punës së Kuvendit, e kemi përmendur edhe një vizitë studimore, para verës. Si është puna e kësaj dhe kur është caktuar data? Pyetja e dytë është për kryetarin: Kryetar, në një konferencë për medie e kam përcjellë Vlora Spancën dhe është ankuar në moszbatimin e rekomandimeve nga komunat përkatëse. Herën e kaluar, nënkryetari më ka informuar që në krahasim me komunat e tjera, qëllojmë më mirë në këtë aspekt. Më intereson të di se ku jemi tani me zbatimin e rekomandimeve? Pyetja tjetër ka të bëjë me kanalizimin e Krushës së Madhe. Sot kemi qenë në terren dhe gjendja është shumë keq. Si zakonisht, topi do të hidhet te “Radoniqi”, sepse ne i paguajmë ata. Kryetar, thirri në telefon dhe krijoje një zgjidhje, sepse gjendja nuk është e mirë, bile besoj që sot është shumë vonë.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të Komunës së Rahovecit. Fillimisht, dua ta ngre një shqetësim të bujqve tanë, ka të bëjë me subvencionet në bujqësi, e di që është në kompetencë të ministrisë, por, si komunë a keni ndonjë informacion? Për Drejtorinë e Arsimit i kam dy pyetje: Sot, anëtarëve të Kuvendit do t’u paraqiten tri vendime për themelimin e tri

çerdheve, dëshiroj të di se a keni buxhet të mjaftueshëm për funksionalizimin e këtyre çerdheve, sepse në buxhetin e vitit 2024 nuk figuron. Tjetra, a janë furnizuar të gjitha shkollat me material për ngrohje, me dru dhe me pelet dhe sa është vlera e kontratës së nënshkruar? Pyetja tjetër ka të bëjë rreth konkursit për drejtor të QKMF-së. Pse nuk ka pasur deri më tani drejtor QKMF-ja? Unë e kam parë statutin e QKMF-së për kriteret e konkursit dhe aty nuk e keni cekur që kandidati duhet t'i ketë 5 vjet përvojë pune si specialist i mjekësisë familjare dhe 3 vjet në fushën e menaxheriale.

**Edonë Kryeziu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sot jemi këtu si përfaqësues të votuesve, të cilët presin përgjegjësi dhe zgjidhje. Është e domosdoshme që ne t'i adresojmë shqetësimet dhe problemet e komunitetit. Udhëkryqi i fshatit Xërxë është një rrezik i vazhdueshëm për banorët dhe ka vite që është kërkuar zgjidhje për ta përmirësuar sigurinë në atë vend. Qarkullimi i automjeteve dhe i autobusëve të mbushur me nxënës është shumë i madh, ndërsa masat e sigurisë janë minimale. E di që kjo është kompetencë e ministrisë, por si Komunë e Rahovecit mund të ndërmerri hapa të rëndësishme, nëse ka vullnet politik. Tani, në prag të zgjedhjeve, e keni një mundësi të shkëlqyer për të ndërhyrë, duke treguar vullnetin për të ndryshuar diçka që qytetarët e kërkojnë ndër vite. Banorët kanë nevojë për zgjidhje dhe jo për premtime të pambajtura. Çerdhet e ndërtuara së fundi, kanë një pasqyrë të trishtuar të infrastrukturës. Dua t'ju sjell në vëmendje situatën e çerdhes në Xërxë. Fotot tregojnë që radiatorët janë të dëmtuar, gjysma janë të vendosur në mur e gjysma në tokë. Në vendin ku rrinë, zhvillojnë aktivitete dhe flenë, raftet nuk janë të mbushura me lodra, por me këpucë. Kryetar, fëmijën tuaj a do ta lejonit të qëndrojë në një ambient të tillë? Për më tepër, në mungesë të lodrave dhe të materialeve bazë, prindërit janë të detyruar të kontribuojnë financiarisht për t'i plotësuar këto boshllëqe. Të gjitha këto që i fola, mund t'i vërtetoni në bazë të faqes zyrtare në facebook, ku janë të postuara të gjitha aktivitetet nga edukatorët. Kërkesa ime është e qartë, ju lus zyrtarisht t'i merrni me seriozitet këto shqetësime dhe të ndërhyni sa më shpejt që është e mundur.

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Për korrektësi, unë i kam dy vajza (binjake) që vijnë në atë çerdhe në Xërxë. E para e punës, unë nuk kam bërë pagesë prej që është hapur çerdhja. E dyta, fëmijët e mi nuk bëjnë gjumë asnjë ditë në çerdhe, sepse janë me orar të shkurtuar. Unë jam shumë i kënaqur me kushtet aty, bile sot i pashë punëtorët teknikë duke punuar në rregullimin e nxemjeve. E inkurajoj Drejtorinë për Arsim që të vazhdojë të punojë tutje.

**Hasan Përboqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, medie, monitorues, qytetarë! Na duhet një informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport rreth përfundimit të punimeve tek Epopeja. Ku është gjendja në këtë fushë dhe a ka shpresa që shumë shpejt klubi t'i zhvillojë ndeshjet aty. Përndryshe, përgëzime prej ish-drejtoreshën Bjondina Kleqka, tani drejtorin Afrim Dina dhe në krye me kryetarin Smajl Latifi! Ky projekt i ka pasur vështirësitë e veta, por në fund po del të jetë një projekt super i mirë. Shpresojmë që shumë shpejt do të shijohet nga ekipi i parë me lojërë vendas, gjithashtu edhe shkollat e futbollit që janë shumë aktive në qytet, si dhe publiku rahovecian që është dashamir i madh i futbollit.

**Kryetari:** I nderuari kryesues i Kuvendit, Arbër Zenuni, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të mediave, KFOR-it, OSBE-së dhe të gjithë ju që jeni të pranishëm! Katërmbëdhjetë asambleistë nuk e kanë dorëzuar biografinë e tyre, gjë që institucionet nuk e dinë se kush janë ata dhe mendoj që është afati i fundit, sepse jemi në vitin e fundit të mandatit. Biografia duhet të publikohet në faqen ueb. Do t'u tregoj qytetarëve që jeni vonuar, 7 janë të Aleancës dhe 7 të partive të tjera. Është kërkesë e zyrës së Kuvendit dhe është mirë t'i dërgoni aty, apo te Blerta Gashi-Nalli. Kam dëshirë që Burim Krasniqit t'i përgjigjet Afrim Limani, për procedurat përmbartimore dhe vlerën e procedurave përmbartimore. Jemi të vetëdijshëm që të gjitha komunat janë në procedura përmbartimore dhe rasti më i freskët është Suhareka, të cilës dje iu kanë bllokuar xhirollogaritë. Nuk kemi çka fshehim, sepse të gjitha janë vendime gjyqësore, si dhe të gjitha këto informacione i kanë kërkuar edhe KDI-ja. Sa u përket procedurave të prokurimit, tani kemi rekomandim dhe insistim nga konsulentët e USAID-it i jepet përparësi kriterit, çmimi ekonomik më i favorshëm dhe nuk ka më vetëm çmimi më i lirë. Nuk është çudi që ndonjëherë nuk e fiton më i liri. Ata janë duke insistuar që edhe në institucionet qendrore të ndodhë një gjë e tillë. Zyrtari i prokurimit i di më mirë këto gjëra. E vërteta është që po të



isha ministër i Infrastrukturës do të ishte kryer autostrada dhe zgjerimi i rrugës. Janë bërë 5 vjet që nuk kanë bërë asgjë institucionet e nivelit qendror në drejtim të zgjerimit potencial të rrugës Rahovec-Gjakovë-Deçan-Pejë-Istog. Këtu jemi dëshmitarë që dikush e ka mbrojtur ministrin pa e njohur dhe unë e njoh shumë para të tjerëve. Tani jemi në një situatë ku e gjuajnë ministrinë sikur një leckë. Së voni është biseduar për zgjerimin potencial të rrugës Prizren-Krushë e Madhe-Xërxë-Gjakovë e tutje. Ministri, me ekipin e tij, ka ardhur dhe ne i kemi mirëpritur këto biseda, për variantet që ata i kanë. Disa shokë të atij që foli, kanë tentuar t'i bëjnë disa "pazare" pa ndonjë alternativë, m'i ka treguar ai. Ministri iu ka bërë të qartë, duke thënë që ne do të bisedojmë me kryetarin dhe me institucionet komunale dhe jo të bëjmë bisedime pa alternativë. Në fund të fundit, kush janë ata që t'i bëjnë presion ministrit. Sidoqoftë, ajo temë nuk është në interes të trajtohet në kuvend. Përndryshe, kam informata aq shumë sa që dikush mund të dalë edhe jashtë sallës së kuvendit. Pazare nuk bën Smajl Latifi dhe kurrë nuk ka bërë. Shokët tuaj i kanë bërë disa takime për disa shpronësime, për disa para dhe për disa interesa. Kjo punë është dashur të bëhet më herët, sepse tani unë nuk besoj që do të ketë zhvillime të shpejta dhe pozitive në zgjerim të rrugës. Problemi është që "pazare" kanë tentuar të bëjnë ata, që dikur kanë iniciuar dikur edhe peticion për interesa totalisht të ngushta. Zgjerimi i rrugës ka rreziqe, sidomos në pjesën e Xërxës. Argument themelor është që prej hekurudhës duhet të largohemi rreth 8m dhe në këtë mënyrë zona e bizneseve bllokohet. Këto janë parimet e prezantuara nga ekipi i ministrisë. Në debat kanë qenë edhe çështjet të tjera që e ndërlikojnë opsionin e autostradës, qoftë zgjerimin. Mos të harrojmë, dy variantet janë të atyre. Unë kam kërkuar që të ketë gjithësi rrugë për mjete bujqësore. A ndodh zgjerimi apo autostrada, kjo është punë e institucioneve qendrore. Zgjerimi ka shumë rrezik dhe kërcënon pronat, pasurinë dhe jetën e qytetarëve, sidomos në Xërxë dhe një pjesë të Krushës. Në bazë të bisedave, biseda ka qenë e hapur, sepse unë nuk shkoj në majë të Zatriqit atje, të fshihem diku prapa antenave. Biseda ka qenë në sallën e institucioneve. Nuk shpresoj që diçka do të ndodhë. Janë ndërprerë negociatat, sepse kanë ndodhur zhvillime të tjera në Ministrinë e Infrastrukturës dhe nuk ka më asgjë. Pas datës 9 shkurt flasim prapë, sepse para zgjedhjeve nuk pritet të ketë ndonjë zhvillim interesant sa të bëhet temë në kuvend. Sejfullah Sejfullahu bëri pyetje rreth ZKA-së: Raporti i ZKA-së zyrtar për vitin 2023 thotë që kemi progres në zbatimin e rekomandimeve. Ju e dini që i kemi pasur 9 rekomandime, 5 janë zbatuar, 4 plotësisht dhe një pjesërisht, 4 rekomandime kanë ngelur dhe 4 të tjera janë shtuar. Te organizimi i KDI-së, unë kam qenë panelist, bashkë me kryetarin e Kamenicës. Kontrata kolektive ne na ka penalizuar. Aty ia kam bërë një pyetje Ismet Kryeziut, shefit të KDI-së, i kam thënë që në qoftë se ju e bëni një analizë të të gjeturave, konkluzioneve dhe rekomandimeve të qeverisë së Republikës së Kosovës, neve është dashur të na vije "marre" të dalim nga takimi. Ata kanë të gjetura, që me të vërtetë i dalin shumë punë prokurorisë themelore dhe speciale. Komunitat po penalizohen për arsye banale, pra, për kontratë kolektive. Për momentin, përkundër kontratës kolektive, ndoshta jemi e vetmja komunë që jemi më komodë. Prej tetë rekomandimeve, ne mund t'i zbatojmë plotësisht 5 prej tyre. Kur ta përfundojmë pikën e dytë të rendit të ditës, do t'i thërras ata të merren me kanalizimin në Krushë. Aty po rikthehen problemet e njëjta me kanalizim. Prej grantit të performancës unë i kam ndarë 498.000€ për këtë projekt që po flasim. Qeveria e Republikës së Kosovës i ka hequr, duke thënë që ju nuk keni të drejtë t'i vendosni aty ku dëshironi ju, si dhe tutje na kanë kushtëzuar që t'i vendosim në projekte të reja. Gjithashtu, ende nuk na kanë dhënë grantin e MAPL-së, ndërkohë që ne e kemi për detyrë që ta harxhojmë sivjet. Me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ne kemi probleme serioze dhe jo vetëm ne, por edhe komunitat e tjera. Dje i kam shkruar ministrit të MAPL-së, kërkesë për veprim urgjent. Te vonesat e subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë, ministri, edhe pse bukur shpesh po vjen në Rahovec, ende nuk ka përgjigje se kur do t'i japë subvencionet. Fillimi i fushatës do t'i ndihmojë t'i lëshojë më shpejt. Vota në Rahovec, jam i bindur që ai nuk do të marrë. Ndërsa me subvencionet tona për blegtorë, pleh kimik dhe serra, jemi shumë në rregull. Udhëkryqi në Xërxë është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës. Aty ka probleme me hekurudhë dhe nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë. Shpresojmë për ndonjë zgjidhje duke e shfrytëzuar rrugën me 4 korsit, në bashkëpunim me bordin e hekurudhave dhe me ministrinë. Për momentin, për shkak të hekurudhave, as ministria nuk ka përgjigje adekuate. Te çerdhja në Xërxë, nëse është gjendja ashtu siç e the ti, deri më tani do t'i kisha mbi 100 ankesa. Nuk e kemi pranuar asnjë ankesë, as te Drejtoria për Arsim. Nuk themi që standardet aty janë të nivelit më të lartë, megjithatë,

gjendja është e pranueshme që do të ketë përmirësime të mëtejme. Tani do të provojmë t'u dërgojmë ushqimin dhe sigurisht pas certifikimit prindërit do të angazhohen edhe për pagesë. Konkursi për drejtor të QKMF-së: Po, është e qartë, është një konkurs. Afati i ushtruesit të detyrës skadon në dhjetor dhe sipas Zyrës së Personelit, konkursi duhet të shpallet dy muaj para. Konkursi është shpallur dhe të gjitha këto që fliten nëpër rrjete sociale, absolutisht janë të parëndësishme. Konkursi është i hapur, mund të aplikojë edhe ai tjetri dhe ky tjetri. T'ju them të drejtën, nuk e fsheh faktin që aty kam dëshirë të jenë të rinjtë, jo që nuk i respektoj të vjetrit, por QKMF-ja ka nevojë për energji të reja. Po ju them edhe një herë, mos bëni kualifikime, keni kujdes me paraqitje për shkak që unë nuk kam pritur që ndonjëherë të më besojë dikush, e sidomos ti! Është irelevante se çka flet ti! Njëri, fillimisht në mëngjes ia filloi ta shante botën, më pas vendin e tij, njerëzit e tij, dikur më vonë shoqërinë dhe në fund në mbrëmje e shante edhe vetveten. Ministrin që ti sot e akuzon që po bën "pazare" me kryetarin, apo me këdo qoftë, për të njëjtën ke qenë në gjendje të flasësh ku ta di se çka. Rri si i pavarur. Merri incizimet e kuvendit edhe shikoje veten se çka ke folur para 6 muajsh, ose para 3 vjetësh. Po ju them që "mos bëni hop pa e kërcyer gardhin". Unë ndoshta me ministrin nuk pajtohem si ministër, sepse më mirë është që unë të isha ministër e jo ai, por provoni që ministrin tuaj t'ia futni minat e ta tërhiqni vëmendjen diku tjetër, sepse 4-5 ministri nuk i kanë punët hiç mirë. Kryetari i komunës është mirë me ligjin dhe jam krenar që jam mirë me ligjin.

**Burim Krasniqi:** Më ka rastisur që në ministri të bisedoj me anëtarët e komisionit rreth zgjerimit të rrugës Prizren – Rahovec – Gjakovë - Deçan - Pejë. Ajo që më ka shqetësuar shumë është që ata janë duke tentuar që rrugën aktuale ta bëjnë 4-shiritore, me dy shirita ndihmës dhe me ndarje fizike, si lloj tipi autostrade. Në takim iu kam thënë që kjo është ngufatje për komplet bizneset dhe për këtë zonë këndeje, sidomos për Krushën dhe Xërxën është fatalitet. Ju kërkoi mirëkuptim që të kemi vëmendjen, qoftë edhe si asamble komunale ta nxjerrim një vendim, që ajo rrugë 4-shiritore të mos jetë me 2 shirita ndihmës paralel dhe jo me shumë elemente të tjera shtesë, sepse kjo është fatale për komunën e Rahovecit.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, media, zyrtarë komunalë! Të tentosh t'u vësh hi në sy qytetarëve të Komunës së Rahovecit, me diskutime të ulëta kundrejt anëtarëve të kuvendit, ka qenë gjithmonë e dënueshme dhe e patolerueshme. Kolegu i përmendi "pazaret" dhe këtu nuk ka diçka të preksh. Me një qeverisje të tillë është normale të dyshosh mbi pazaret që bëhen. Ju i keni dhënë tender gati 1 milion euro, koleges tua, deputetes së kuvendit nga radhët e Aleancës. Oferta ka qenë më e shtrenjtë se oferta më e lirë, siç e përcakton ligji i prokurimit. Ofertuesi, burri i deputetes së Aleancës, ka qenë më e shtrenjtë se oferta më e lirë, si mos të dyshohet për "pazare". Pajtohem me ty, që krejt ata që bëjnë "pazare", qofshin edhe shokët e mi, përmendi me emër çdo shokë tonin që bën pazare, se përderisa nuk e përmend me emër, ti po shpif. Nuk është mirë me shpif prej foltores së Kuvendit Komunal. Nuk është mirë t'ua thonë qytetarëve një të pavërtetë.

**Kryesuesi:** Defrim, vërejtja e fundit, mos bën elaborime dhe komente të tepërta, si dhe dy minuta të kanë kaluar.

**Defrim Kafexhiu:** Krejt ata që bëjnë "pazare", duke i përfshirë edhe shokët tanë, duke e përfshirë kryetarin edhe neve, e kanë vendin atje ku e kanë vendin kriminelët. Këtu, në kuvend komunal, politikë nuk është mirë të bëhet, sidomos tani në kohë fushate. Politikat bëhen nëpër tubime elektorale, në rrugë e nëpër forume partiake. Ti po na akuzon ne që po bëjmë fushatë, ne nuk jemi kandidatë, ti je kandidat, kryetar. "Sa vota i merr Faton Peci" nuk përshtatet me temat e diskutimit që po i bëjmë në kuvend. Faton Peci i ka punët e veta dhe këto lidhjet e shkurta që po ia përmend, nuk janë të rëndësishme për këtu. Le ta marrë secili atë që e meriton, varet prej punës që bën. Dua të përmend edhe diçka tjetër. Kjo sjellje kundrejt Ilirit është e patolerueshme, sepse pothuajse është njëjtë sikur mua të ma bëjë. Te debati "Jeta në Kosovë" e keni përmendur çështjen e stadiumit. Tash t'i marrim këto kamerat e "Kosova Press"-it dhe ta shikojmë se çka ke thënë për propozimin e Ilirit për stadiumin, del që ti "hajgare" ke bërë me atë propozim. Tani del nëpër çdo emision edhe te "Jeta në Kosovë" krenohesh me projektin e stadiumit të ri të qytetit. Nuk bën kështu, duket t'ia japësh hakun atij që e jep një kontribut, qoftë edhe me një propozim. Te prioritetet qeverisëse të Smajl Latifit, prej mandatit të parë kanë qenë: Arsimi, agroturizmi, shëndetësia, bujqësia. Te çështja e bujqësisë, po e pyes kryetarin, qendra

magazinuese ku është si projekt, sepse ka kaluar afati që është dashur të përfundojë ky projekt që bujqit është dashur tani t'i shfrytëzonin ato hapësira që po bëhen me buxhet të komunës. Në shëndetësi, premtimi i kryetarit ka qenë: Mbulimi i shpenzimeve të pacientëve me sëmundje kronike. Çka ka bërë kryetari i komunës përgjatë tre mandateve për pacientë me sëmundje kronike? Te çështja e agroturizmit, çka keni bërë si kryetar? Përveç rrugëve fushore, sepse rrugën fushore nuk e përbëjnë atë çështjen e agroturizmit si term. Te arsimit: Në prioritetet e keni vendosur që ne po punojmë për një mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore. Në çdo vit pas viti, nuk ka pasur kurrë më shumë mungesa prej nxënësve, nëpër shkolla të mesme. Mungesa e interesimit të nxënësve është e madhe për këtë mësimdhënien që ju po e ofroni me politikat lokale të arsimit. Po ashtu, nxënësit edhe prej shkollave fillore po zgjedhin rrugë të tjera të arsimit dhe jo shkollat publike të Komunës së Rahovecit. Kryesues, më fal që e zgjata pak, faleminderit shumë për kohën!

**Kryetari:** E para, unë jam udhëheqës politik këtu dhe a bëj politikë apo jo, është vetëm çështje e imja individuale, si dhe e edukimit tim politik. Për momentin nuk kam pasur nevojë të të pyes edhe pse të kam deklaruar si këshilltar special. E dyta, nuk bëj pazare dhe nuk kam bërë asnjëherë. Absolutisht, pazare bëjnë shokët tuaj, ju kallëzoj emrat kur të dalim jashtë. E treta, unë u përgjigjem qytetarëve dhe natyrisht jap llogari edhe në kuvend, si dhe veproj në pajtim me ligjin. Ministri Faton Peci, është ministri më i papërgjegjshëm i Ministrisë së Bujqësisë që e ka pasur ndonjëherë Republika e Kosovës. Njerëzit më bëjnë pyetje pse janë vonuar subvencionet, sepse aplikimet kanë ndodhur në prill. Ia kam thënë edhe para Jeta Xharrës, ia them edhe para RTK-së dhe ia përplasi në fytyrë edhe në mbledhje të qeverisë, nëse ftohem si kryetar komune. Unë mbroj interesin publik. Te çështja e zgjerimit të rrugës, as atëherë, as sot, as asnjëherë, Smajl Latifi nuk ka pasur interes. Ne nuk jemi vendimmarrës, por, nëse japim kontribut e bëjmë për qytetarët. Ne i japim komentet tona në bazë të informatave gjeodezike, kadastrës, pronës, tokave bujqësore etj... Sa i përket çështjes rreth sjelljes ndaj asambleistëve, ju lutem, asnjëherë nuk ia filloj i pari, por ai që ia nis do t'ia kthej 100% dhe dua të thirrrem në atë thënien speciale të Burimit: "ne jemi këtu". Nuk ndodh kjo nëse dikush më quan pazarrxi, kriminel ose bllokues, e unë të mos ia kthej. Ia kam kthyer edhe kur ka qenë tepër vështirë, cilitdo që ka tentuar të ma denigrojë personalitetin. Gjithashtu edhe ty, nëse dikush tenton të të denigrojë, unë jam mbrojtësi numër 1. Në këtë kuvend shpifjet nuk kanë vend. Unë i tregova temat që janë diskutuar me ministrin dhe thashë që nuk pritet të ketë zhvillime të shpejta. Unë jam kandidat për deputet, ende nuk e kam zyrtarizuar, por jam. Mos harroni, kurrë në këtë kuvend nuk i përziej gjërat me kandidaturën time për deputet. Nëse ka mbetur puna që këtu t'ju kërkoj votën juve, e keni shumë gabim. Këtu jap përgjigje për secilën qeveri, nëse është interesi i komunës së Rahovecit. Pastaj, pse po e vonojnë hartën zonale? Tani kur duhet të nënshkruhet për ta vendosur në diskutim publik, është arrestuar sekretari i përgjithshëm i ministrisë! Tani vonohet përsëri. Ne jemi të gjallë, jemi dinamikë, kemi informacione që nuk janë për kuvend, por kanë adresa të tjera. Mos harroni, tani për një nënshkrim unë vuaj, sepse nuk e kemi sekretarin e përgjithshëm dhe nuk ka u.d. Janë fenomene të çuditshme. Shumë kanë qejf të më ngrenë edhe aktakuzë, po çfarë të bëj unë, jam kështu, kam qëlluar burrë i mirë dhe kryetar i mirë. Te pyetja, çka keni bërë në arsim? Mos bëni hajgare, ne kemi ndërtuar shkolla të reja, kemi rinovuar shkolla, kemi zbatuar programin e eficiencës së energjisë, kemi bërë pakon pedagogjike që nuk e ka bërë asnjë komunë e Republikës së Kosovës dhe i kemi realizuar të gjitha premtimet për mësimdhënie dhe mësimnxënie. I kemi furnizuar me laboratorë, me pajisje të teknologjisë informative. Unë e di që këtu në kuvend ka njerëz të mençur që ia ftohin edhe GAP-it e administratës së Biden-it. Premtimet e realizuara dhe të evidentuara janë nga GAP-i dhe unë nuk kam asnjë komunikim me ta. Te premtimet e përmbushura janë 53, bile duhet të jenë 55, sepse 2 premtime kam dilema pse nuk i kanë pranuar. I kam marrë përgjigjet pse janë hequr dhe deri në fund të mandatit të gjitha do të jenë të përmbushura, gjysmë të përmbushura dhe eventualisht ndonjë premtim i filluar. Këtu matemi me punë, jo kush po flet më mirë. Në shëndetësi: Ekipi mobil ofron shërbime falas edhe te njerëzit me sëmundje kronike. E dyta, njerëzve që kanë sëmundje, ne iu japim një ndihmë simbolike për t'ua lehtësuar barrën. Janë me qindra raste të tilla. Në shëndetësi dhe në arsim, dukshëm ka zhvillime të mëdha.

**Eqrem Spahiu:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Te sanimi i problemeve në AMF-në e Optrushës, a është ndërmarrë ndonjë gjë apo do ta ketë fatin e njëjtë sikur sistemi i ujitjes pikë-pikë? Gjithashtu, a duhet dikush të japë llogari në lidhje me këto probleme?

**Ilir Pallqa:** Kryetari e përmendi që dikur i kemi thurur lëvdata ministrit. Unë nuk i kam thurur lavde ministrit që 4 vjet, por, e lëvdoj nëse bën diçka të mirë për Rahovecin, kur bën keq e kritikoj. Unë kam qenë pjesë e peticionit dikur. Unë jam kundër interesave të ngushta që janë në dëm të komunës, qoftë edhe shok e familjar i imi. Liburn Aliu, fjalë për fjalë ka thënë publikisht: “Jam kundër autostradës, jam për zgjerimin e rrugës”. Gjithashtu, në atë kohë kur e ka thënë, hekurudha ka qenë aty ku është tani. Unë nuk po flas me ekspertizë, por vetëm si banor që kam hall si i përzgjedhur edhe pse ndonjëherë kryetari po më nënçmon, por jam i zgjedhur, s’kam çka të bëj. Për ekspert jeni ju, e keni dëshmuar ekspertizën tuaj lart e poshtë, e kemi parë, po e shohim. Unë fola, që kjo, sipas bindjes time, është dëm i pakthyeshem i komunës, kjo është bindje personale. Nëse kryetari po mendon që kuvendi nuk është vend ku flitet kjo, atëherë ne ulemi me ndonjë qebaptore edhe flasim.

**Hasan Përboqi:** Mirë që Iliri po bindet që asgjë nuk kanë bërë, e as nuk do të bëjnë për Rahovecin. Prej përvojës me këto, mund të garantoj që as ky projekt në Xërxë nuk do të bëhet, por, tani është kohë fushate edhe i duhet për ndonjë votë. Mos u “tut” Ilir, nuk do të ketë as zgjerim, as autostradë. Zgjerimi i rrugës ka mundur të bëhet edhe më herët para 4 vjetësh kur kanë ardhur në pushtet, por tani që po vijnë zgjedhjet i ka shkuar mendja për këto ide. Pas zgjedhjeve, këto gjëra harrohen, por “inshallah” ky ministër nuk vjen më.

**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, të nderuar asambleistë! Do t’i përgjigjem pyetjes së Burimit. Deri më tani, ngarkesa financiare e kontratës kolektive është 5.155.000€, nga kjo shumë deri më tani janë paguar 2.704.00 dhe kanë mbetur edhe 2.451.000€. Për pjesën e mbetur, ne e kemi adresuar një kërkesë në Ministrinë e Financave, me mundësinë që kjo vlerë të bartet në 3-mujorin e ardhshëm të vitit 2025. Vlera e pagesave ndër vite, për kontratën kolektive: 2021 - 8268€, 2022 - 173.400, 2023 - 825.880, 2024 - 1.696.000€. Rreth 98% e këtyre janë të ekzekutuara nga kategoria e pagave dhe e mëditjeve. Lirigzoni bëri pyetje rreth buxhetimit të tri çerdheve: Përkundër dy kërkesave që i kemi bërë para qarkores së parë dhe të dytë buxhetore, nuk na kanë aprovuar dhe faktikisht tri çerdhet kanë ngelur si të pabuxhetuara. Ne si komunë, nga programi i administratës së përgjithshme kemi menduar për këtë gjë dhe i kemi ndarë 230.000€ për funksionalizimin e tri çerdheve.

**Burim Krasniqi:** Kur të keni kohë, sa është vlera bazë e shpenzimeve gjyqësore dhe përmbartimore, bashkë me kamatë?

**Afrim Limani:** Të thashë që e kam vlerën totale, bashkë me shpenzimet e kamatës, që janë prej 5.155.000€ dhe matematikisht t’i mund ta shumëzosh me 8% dhe në fund të del kamata, pa shpenzime administrative.

**Afrim Dina:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit! Pata një pyetje nga z. Hasan Përboqi. Në kompleks sportiv janë duke u bërë të gjitha përgatitjet e fundit që K.F. “Rahoveci” dhe klubet e tjera të komunës tonë t’i zhvillojmë ndeshjet vendas. Shpresojmë që loja K.F. “Rahoveci” me “Lirinë” të luhet në kompleks sportiv.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Pyetja ime është rreth projektit të kullimit të tokave, Fortesë - Celinë. Po e shoh që janë duke u bërë disa kanale të hapura. Pyetje është kështu: Për të gjitha ujërat që vijnë, a do të bëhet një kanal përskaq asfaltit, në mënyrë që uji të bartet në kanalet tjera?

**Drilon Mustafa:** Përshëndetje kryesues! Përshëndetje për të gjithë kolegët. Do t’i bëj dy propozime për stafin e kryetarit. Propozimi i parë: Të bëhet një deponi për mbetje të ngurta në zonën kadastrale - Kramovik. Aty është një pjesë e rrethuar prej 3 ha, e cila është shfrytëzuar për zhavorr për nevojat e autostradës. Brenda aty është një gropë ekzistuese dhe kompania në fjalë ka licencë për shfrytëzim për 5 vjet, i ka mbetur edhe 1 vjet. Prona do të kalojë si aset i komunës dhe ta shfrytëzojmë si deponi për mbetje të ngurta. Propozimi i dytë: Ky propozim ka të bëjë me sheshin qendror. Ditëve të fundit po e shohim që sheshi po e merr formën e duhur. Ka mbetur pa u trajtuar hotel “Park Plaza”. Hoteli e ka një arkitekturë të mire për objekt administrativ dhe propozoj që institucionet komunale të vendosen në atë objekt. Arsyet e mia janë të shumta. Ka të bëjë gjithashtu edhe me zhvillimin e politikës në Evropë, që institucionet të vendosen në



sheshe qëndrore, të cilat aty bartin më shumë siguri. E lus kryetarin dhe stafin e tij që këto dy kërkesa t'i marrin me seriozitet, të ma kthejnë një përgjigje apo t'i ekzekutojnë.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit! Unë nuk dëshiroj të flas më, sepse kam folur mjaft, por, pas asaj që dëgjova, “niveli qëndro e niveli lokal” më shkoi mendja te Gjergj Fishta kur e pyetën se çka mendon për shqiptarët: “Shqiptarët janë shumë njerëz të mirë, por janë të çuditshëm, sepse më tepër gëzohen kur t'i ngordhë lopa kojshisë, sesa kur “pjellë” e vetja”. Duke i parë të gjitha këto zhvillime që po pengohen nga niveli qendror në atë lokal, propozoj që si ndërmjetësues ta marrim Lajçakun ose grupin e Quint-it.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, 2024-2026:**

**Alban Gashi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. Ky plan është një përpjekje e përbashkët e grupit punues për hartimin e planit të veprimit, mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje në Rahovec, nën koordinimin e zyrës së kryetarit dhe me përkrahjen e misionit të OSBE-së në Kosovë. Plani bazohet sipas ligjit nr. 08.L/185. Dokumenti ka qenë në konsultim publik nga data 15 gusht-16 shtator dhe konsultimi publik me qytetarë është mbajtur më 9 gusht. Pjesëmarrësit kanë dhënë ide, të cilat janë inkorporuar në brendi të planit. Plani është i mbështetur në tri objektiva strategjike: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe objektiva e tretë është fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit! Në emër të grupit e përshëndes këtë iniciativë. Rastet me dhunë në familje, nga janari deri në shtator 2024 janë 37. Sipas ligjit, komunat janë të detyruara t'i formojnë këto mekanizma. Një pyetje: Sa është buxheti i ndarë nga ana e komunës për funksionimin e planit të veprimit?

**Defrim Kafexhiu:** Dua të të pyes rreth bashkëpunimit të zyrës së juaj me Qendrën për Punë Sociale, si është raporti?

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Komuna bashkë me QPS-në, a kanë shërbime të psikologut? Ato gra, apo ata fëmijë që i nënshtrohen dhunës në familje, a kanë trajtim falas te psikologu? Nëse jo, ju kërkoj që në të ardhmen të realizohet, nëse ka nevojë marrim edhe vendim si asamble komunale, që ky shërbim të realizohet qoftë për atë që e ka ushtruar dhunën në familje, qoftë për atë që i është nënshtrohet dhunës në familje.

**Alban Gashi:** Te pyetja e Lirigzonit, rreth buxhetit: Buxheti për këto 3 vite prej komunës dhe prej donatorëve është 25.000€. Sa i përket raportit me QPS-në, vetë drejtori e ka nënshkruar dhe është anëtar i këtij mekanizmi. Te pyetja e Burim Krasniqit, ndoshta duhet t'i përgjigjem me shkrim, pasi edhe Drejtoresha e Shëndetësisë nuk është këtu.

**Kryesuesi:** Faleminderit Alban Gashi. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (20) aprovohet pika e tretë.

### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2024-2028:**

**Bjondina Ramaj:** Përshëndetje për kryesuesin, drejtorët, asambleistët. Është kënaqësi që para jush të shpalosi në pika të shkurta Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2024-2028. E falënderoj shumë drejtorin për përkrahjen dhe për punën e përbashkët. Ky plan nuk ka mbështetje nga donatorët apo dikush tjetër. Ne si drejtori e kemi punuar bashkë me grupin punues. Plani është voluminoz, i ka të përfshira të gjitha udhëzimet dhe ligjet e komunës dhe ministrisë. Të gjitha janë të prekshme, asgjë nuk është shënuar e që në realitet nuk mund të realizohet. Prioritetet: Mbrojtja e resurseve dhe menaxhimi ujqor, përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional për mbrojtje të mjedisit.

**Burim Krasniqi:** Sa i përket mbrojtjes së ujërave, a është kompetencë e komunës apo e Agjencisë për Menaxhimin e Ujërave dhe në çfarë kuptimi mendohet t'i mbrojmë ujërat?

**Bjondina Ramaj:** Siç e din edhe ti, mbrojtja e ujërave është në kompetencë të ministrisë. Mbrojtjen e ujërave mendojmë ta zhvillojmë duke i pastruar të gjitha përroskat që i kemi në komunën tonë. Në bazë të udhëzimit administrativ për leje ujore, ne jemi kompetentë për një sasi të vogël, për disa puse, për të tjera është ministria.

**Kryesuesi:** Faleminderit Bjondina Ramaj! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër...? Me shumicë votash (19) aprovohet edhe pika e katërt.

## **5. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar-shtator 2024:**

**Afrim Limani:** Faleminderit! Ky është raporti financiar janar-shtator. Të hyrat bashkë me gjoba të gjykatave dhe të trafikut janë 1.640.000 dhe kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, kemi një diferencë në negative prej 49.938€. Në këtë raport i kemi të paraqitura të hyrat e analizuara në mënyrë analitike sipas kodeve ekonomike. E kemi shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë. E kemi shpenzimin e buxhetit deri në këtë periudhë, i cili është 17.466.000€ (81.36%). Qëndrojmë mirë edhe te investimet kapitale, ku deri më tani në këto momente që po flasim, i kemi shpenzuar 84-85%. Në këtë raport i kemi të përfshira në mënyrë analitike edhe shpenzimet e kategorisë mallra dhe shërbime, raportin e shpenzimeve për komunalit dhe krejt në fund i kemi raportin e kontratave të lidhura deri më tani. Kontratat janë me furnizime në shërbime dhe të investimeve kapitale 7.964.000€.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Në faqen 16, te tabela 3.4 - furnizimi me dru, në vitin 2024 ka 100% rritje të vlerës. A ka një arsye pse është 100% më e madhe? Prej 148.324€ në 235.568€. Tjetra, nuk e pashë askund furnizimin me pelet, a përfshihet edhe peleti bashkë me dru, apo pjesa e peletit është kod i veçantë? E fundit, kontratat janar-shtator 2024 e kapin vlerën rreth 8 milionë euro, si qëndron çështja e mbulueshmërisë financiare për këtë projekte? A pritet që projektet që janë dy vjeçare, të zgjasin më shumë se dy vjet dhe të vazhdojnë deri më 2027-2028?

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Detyrohem të dal pak jashtë temës, por, te të hyrat prej gjobave në trafik po e shohim se shifra më e vogël se në vitin e kaluar, dallimi është rreth 30% më pak. E ftoj kryetarin që në mbledhjen e KKSB-së të shtrojë çështjen e parkingut joadekuat në trotuare, qoftë ditën edhe natën. E dimë që është përgjegjësi komplet e policisë, por të paktën është mirë që ky problem të fillojë të përmirësohet.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Faqe 11, tabela 3.3, te mallrat dhe shërbimet: Saktësisht te shërbimet kontraktuese tjera, po e shoh që zyra e kryetarit në vitin 2023 shërbime të tilla ka në vlerë prej 8451€, kurse këtë vit 180€. Po ashtu, administrata në vitin 2023 ka 6366€, kurse këtë vit 1409€. Një sqarim rreth kësaj?

**Afrim Limani:** Faleminderit për pyetjet! Burim, mund të ndodh që ndonjëherë kemi shpenzim më të madh se sa gjendja aktuale, sepse ne kemi faturën në dispozicion, kemi mjete financiare dhe bëhet ekzekutimi. Treguesi më i mirë që e përcakton gjendjen dhe krahasimin në mes të dy viteve është fundiviti fiskal. Në këtë raport nuk e kam prezantuar raportin e obligimeve kontraktuale, sepse atë bëhen në fund të vitit fiskal dhe do të shihen të gjitha. Sa i përket mbulueshmërisë të investimeve kapitale, matematikisht qëndrojmë mirë. Në krahasim me vitet e tjera, duhet të pranoj se në kategorinë mallra dhe shërbime kemi obligime më të mëdha, por besoj që deri në fund të vitit do t'i menaxhojmë mirë. Defrim, përafërsisht të hyrat janë të njëjta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sepse jashtë raportit që e keni ju, para dy ditëve ka ardhur edhe raporti i gjobave të gjykatave dhe të trafikut dhe kur i analizojmë dalin përafërsisht njëjtë. Çfarë shpenzime janë në kuder të “te shërbimeve kontraktuese tjera”. E kemi një kompani që e ka fituar projektin për mbikëqyrje dhe një në fatur i ka 38.000 dhe fatura tjetër është 30.000 për t'u paguar. Për mbikëqyrje të projekteve dalin të jenë rreth 60.000€. Hartimi i projekteve për fermerë, 29.000. Trusti pensional i konsulentëve, 4000. Vaksinimi i qenve endacakë, 33.000€. Hartimi i planit komunal për energji të qëndrueshme, 3820€. Hartimi i planit lokal për biodiversitet dhe për cilësi të ajrit, 51.000€. Rrënimimi i objekteve pa leje, 32.000€ dhe AZHR-ja 7700€.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit kryesues! Te faqja 10, te karburanti për vetura në vitin 2023 shpenzimi ka qenë 9400€, kurse në vitin 2024 është 11.800€. Me sa e di unë, vitin e kaluar karburanti ka qenë më shtrenjtë. Kryetari i përdorë veturat zyrtare me të drejtë edhe për të shkuar te mbledhjet e asociacionit të komunave. Kryetar, çka ndodhi në atë asociacion?

**Kryetari:** Faleminderit! Në çdo mbledhje të KKSB-së ne i ftojmë policinë, që të reagojë dhe t'i lirojë trotuaret. Marrim çdo herë zotime, mirëpo veprime konkrete jo edhe shumë. Ne e kemi potencuar faktin që ka vetura që “flenë” me javë nëpër trotuare, sidomos prej stacionit të autobusëve e lartë. Ju mund t'i lexoni edhe procesverbalet, vërtetë çdo herë i kemi këto kërkesa, sepse gjithmonë në KKSB merr pjesë edhe komandanti i stacionit policor. Veturën zyrtare e përdori më pak se sa që mendon dikush. Pas orarit të punës, e përdori vetëm veturën private. Kanë disa që mos i përdorni veturat

zyrtare, e këta që kanë thënë kështu po i përdorin vetë dhe kjo është keq, përkundër asaj që kryetari, ministri, kryeministri e kanë të drejtën ligjore ta përdorin 24 orë. Te shërbimet e karburantit marrin pjesë edhe zjarrfikësit, si dhe ndonjë veturë zyrtare që përdoret nga OJQ-të. Shumat janë minimale dhe besoj që është brenda planit. Te asociacioni, dikush ka menduar që ka të drejtë dhe ka tentuar ta bllokojë foltoren. Bordi i asociacionit e ka ndërprerë aktivitetin, sepse ata e kanë bllokuar foltoren. Statuti është statut dhe nuk ndërrohet shpesh. Iliri, ti ke qenë me një parti, tani je i pavarur dhe ne nuk mund ta ndërrojmë statutin e komunës veç pse ti je i pavarur. Aty kam qenë në rolin e një “zjarrfikësi” edhe pse kurrë “zjarrfikës” nuk kam qenë, por në atë rast Ramiz Lladrovci ka pasur të drejtë. Ka ndodhur njëjtë sikur ju tani ta votoni rendin e ditës dhe të ngrihet Ilir Pallqa e të thotë që nuk do ta vazhdoni mbledhjen e kuvendit. Sidoqoftë, Asociacioni i Komunave është një subjekt shumë i rëndësishëm me një rol të rëndësishëm. Dallimet për momentin janë vetëm me qeverinë, sepse nevoja për përkrahje është e madhe dhe mungesa e përkrahjes është e evidente. Përplasje fizike nuk ka pasur edhe pse ka qenë e mundur të ketë. Komunitetet veriore ne i respektojmë shumë. Dikush është aty me 100 vota edhe pse është kryetar komune. Ideja ka qenë që “duhet të përfaqësohemi në asociacion”, por, nëse nesër mbahen zgjedhjet atje dhe fiton një kandidat serb, atëherë bordi i asociacionit do të dominohet nga elementi etnik dhe mund të kemi probleme në vendimmarrje.

**Ilir Pallqa:** Te asociacioni aty, a jeni duke e diskutuar “grantin e katërt”, sepse ka qenë premtim elektorale?

**Kryetari:** Një nga premtimet e kësaj qeverie, qysh para 5 vjetësh është që “granti i katërt” do të jepet për komuna! “Njërin nga Gjakova e pyetnin, çka u bë kështu, ti ke thënë vetë? Çfarë të bëj, i kam hëngër fjalët e mia”. Unë nuk i takoj këtij koncepti politik. Granti i katërt do të ishte zgjidhje fatlume për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Shqetësimi i parë që e paraqet Agim Aliu në emër të asociacionit është “granti i katërt”.

#### **6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, P-00772-10, ZK- Xërxë:**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para jush e keni materialin për plotësim-ndryshimin e vendimit të datës 23 gusht të këtij viti. Nga MAPL-ja është rekomanduar që të ndryshohet pak procedura dhe nga dhënia në shfrytëzim në periudhë afatgjatë, të bëhet përmes shprehjes së interesit.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (18) aprovohet pika e gjashtë.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesë e parcelës, 05537-2, ZK- Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Po shpallim me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës 05537-2, ZK – Rahovec, në dalje të Rahovecit, me sipërfaqe 5.4m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 300m<sup>2</sup> në vendin e quajtur Przhina me pronar Timendar Shtavica. Gjatë ndërtimit ka prekur një parcelë të komunës dhe ka pasur kërkesë të vazhdueshme për legalizim të objektit. E kemi shqyrtuar kërkesën dhe qëllimi i këtij vendimi është këmbimi i pronës private me atë komunale.

**Defrim Kafexhiu:** Drejtor, çka pason pas këtij vendimi dhe pse në material nuk është ortofotoja? Një pyetje tjetër: Ku është interesi i komunës së Rahovecit për ta rregulluar këtë pjesë të parcelës, duke e ditur që ka edhe objekte të tjera që janë në të njëjtin proces?

**Burim Krasniqi:** Drejtor, a është objekti në rrugën për Brestoc? Në gjeoportali po e shoh që në 80% të parcelës është objekti i ndërtuar dhe nuk është ashtu siç shkruan në vendim, sipërfaqja 5.4m<sup>2</sup>. Nuk e di kush është pronari, nuk dua të paragjykoj, por objekti është i ndërtuar i tëri në këtë parcelë.

**Afrim Oruqi:** Objekti nuk është pronë komunale, është privat.

**Nënkryetari:** Burim, para ndërtesës për banim kolektiv është një shtëpi private dhe aty është 5-6 metra që dalë jashtë pronës private, duke u futur në pronë të komunës.

**Afrim Oruqi:** Defrim, në këtë drejtim nuk kemi kërkesë të patrajtuar të banorëve. Kur ka kërkesë që objekti e ka prekur pronën publike, analizohet nga Drejtoria e Urbanizmit dhe e Kadastrës dhe nëse rrezikohet trotuari apo rruga, ne nuk e

vendosim në kuvend. Vetëm nëse është interes të përgjithshmin, në këtë rastin edhe tonin si komunë. Me këtë variant në të ardhmen veç zgjerohet rruga dhe në terren asgjë nuk humbim.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (19) aprovohet pika e shtatë. Vazhdojmë me pikat 8, 9 dhe 10-të, sepse ndërliken mes vete.

**8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe të Komunës së Rahovecit:**

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Ratkoc të Komunës së Rahovecit:**

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë të Komunës së Rahovecit:**

**Avni Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, anëtarë të kuvendit, drejtorë, drejtoresha. Kam kënaqësinë që sot, në emër të kryetarit të komunës t’ju propozoj një propozim-vendim që është në përputhje me nenin 3 dhe 7 të udhëzimit administrativ të MASHT-it NR. 10/2023, për kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare. Këto tri propozim-vendime vijnë si rezultat i angazhimit tonë që e kemi pasur gjatë muajve të fundit. Kemi marr pëlqimin nga Ministria e Arsimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Xërxë dhe sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it nr.10/23 duhet të merret miratimi nga kuvendi komunal. Paraprakisht, komuna jonë i ka plotësuar të gjitha kriteret e këtij udhëzimi administrativ. Kodet e institucioneve janë këto: Krusha e madhe e ka kodin 250/3, Ratkoci 250/2 dhe Xërxë 250/4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, absolutisht nuk jemi kundër në kuptimin parimor. Në momentin që bëhen institucione të pavaruara, a rritet numri i punëtorëve dhe a krijon kosto financiare për Komunën e Rahovecit dhe a ekziston mundësia që këto të jenë në kuadër të një institucioni. Kam informata që është sfidues numri i fëmijëve në çerdhe dhe ne jemi duke i bërë institucione, një drejtor, një administratë dhe ende pa e testuar mirëfillshëm këtë punë, ndoshta është pak herët?!

**Avni Morina:** Ne si Drejtori e Arsimit kemi bërë kërkesë për pëlqim për themelimin e këtyre institucioneve, duke iu përmbytur të gjitha kriteret që kërkohen sipas udhëzimit administrativ. Secila prej çerdheve ka pëlqim dhe vendim të veçantë dhe sipas komisionit të MASHT-it të tri çerdhet i plotësojnë kriteret për të qenë institucione të pavarura edukative të fëmijërisë së hershme. Sfidë e kemi Krushën e Madhe që për moment janë 23 fëmijë, ndërsa në Xërxë janë mbi 80 dhe në Ratkoc janë 75. Shpresojmë që edhe në Krushë të Madhe do të rritet numri i fëmijëve, sepse ka shumë prindë që fëmijët e tyre i dërgojnë në çerdhe private në Krushë të Vogël. Në momentin që themelohen këto institucione, neve na hapet rruga të hapim konkurs për drejtorë apo drejtoresha.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Drejtor, të përgëztoj për punën që po bëni. A e keni menduar pjesën e punëtorëve teknikë, që të kujdesen për ngrohje qendrore?

**Avni Morina:** Do të kemi nevojë edhe për mbështetës teknikë, sidomos për periudhën e dimrit. Për momentin, kemi argumente të mjaftueshme për Ministrinë e Financave që të paktën prej vitit të ardhshëm ta rrisim stafin mbështetës, por edhe për edukatore.

**Iliri Pallqa:** E përgëztoj Shqipën për përgëzimet që po i bën. Kryetari, për çerdhen në Opterushë që e keni pasur premtim elektorale, a ka diçka?

**Kryetari:** Për t’ia kujtuar vetes premtimet, e ka pasur për Opterushë, Drenoc dhe Qifllak. Në praninë tuaj atë ditë, i thashë Jeta Xharrës që, nganjëherë njeriu nuk mund ta ketë analizën dhe informacionet deri në fund. Raporti i UNICEF-it dhe MASHT-it ka thënë që nuk parashihen çerdhet në këto lokalitete. Nuk e ka pasur premtim të programit zgjedhor, por të paraqitjes te Jeta Xharra. Përndryshe nëse ka fëmijë, do të ishte mirë që edhe në këto lokalitete të ketë çerdhe. Sidoqoftë, unë nuk i premtoj 160 çerdhe dhe të ndërtoj kaq pak në Republikën e Kosovës.



**Iliri Pallqa:** Kryetar, të ftoj që mos të merresh më me këto premtime lokale, por të merresh me ato gjenerale në nivel të Kosovës, saktësisht ta premtosh fuqishëm “grantin e katërt” dhe ta japësh fjalën që nëse bëhesh deputet e lëshon postin e kryetarit të komunës, kjo t’i rritë gjasat që të bëhesh deputet.

**Kryetari:** Faleminderit, këshilltar i dytë special, pas Defrim Kafexhiut. Njëri nga vetëvendosja dhe tjetri i pavarur dhe me këtë të fundit duhet të kem kujdes më të madh, sepse ka mundësi që do të jemi bashkë në paraqitjen e zotimeve para publikut.

**Leonard Morina:** Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegë asambleistë. Me sa e kuptova, këto tri çerdhet do të jenë të pavarura nga njëra tjetra. Ky staf që është punësuar në këto tri çerdhe, a e kanë listën e pagës me emrin e çerdhes, apo janë të shpërndara nëpër shkolla të komunës së Rahovecit?

**Avni Morina:** Programi i arsimit i ka tri nivele: Programi parafillor, programi fillor i mesëm i ulët dhe programi i mesëm i lartë. Në listë të pagave, në çerdhen “Tulipanët” në qytet janë vetëm 9. Aty kemi angazhuar me të drejtë edhe edukatore shtesë, të cilat janë në programin parafillor. Raste të tilla kemi raste edhe në çerdhe të tjera, sepse i takojnë të njëjtit program.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e vendosim në votim pikën e parë të propozuar nga drejtori. Kush është për?... Kundër?... Me shumicë votash (24) aprovet pika e tetë. Kush është “për” aprovimin e pikës së nëntë? Kundër?... Me shumicë votash (24) aprovet edhe pika e nëntë. Kush është “për” aprovimin e pikës së nëntë? Kundër?... Me shumicë votash (24) aprovet edhe pika e dhjetë.

#### **11. Shqyrtimi i informatës nga DMSH-ja, lidhur me situatën e zjarreve gjatë sezonit të verës:**

**Besmirë Bytyqi:** Faleminderit kryesues! Të nderuar të pranishëm, në emailat e juaja e kemi pranuar një informatë të shkurtër në lidhje me situatën e zjarreve gjatë sezonit të verës. Gjatë muajit korrik-gusht, periudha në të cilën temperaturat kanë qenë shumë të larta, territori i komunës është përballur me një situatë alarmante të zjarreve dhe janë kapluar dhjetëra hektarë tokë. Zjarrfikësit tanë që me numër janë vetëm 17, kanë punuar me përkushtim të madh në lokalizimin e zjarreve. Në korrik kanë ndodhur 79 vatra të zjarreve, në muajin gusht, ekipi ynë ka intervenuar në 80 vatra. Komuna e Rahovecit ofron gjithë logjistikën për njësinë e zjarrfikësve në Rahovec, në mënyrë që ta lehtësoj punën e tyre, e cila sa është e vështirë, është edhe e rrezikshme për shëndetin dhe jetën e tyre.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit drejtoreshë për informatën! Ashtu siç kemi kritika e kërkesa, rendi e don që edhe t’i përgëzojmë zjarrfikësat për punën e bërë, sidomos në terrenin e Krushës dhe më vjen keqardhje për gjendjen e tyre dhe kushtet jo të mira të punës.

**Defrim Kafexhiu:** Gjithashtu e përgëzoj njësitin e zjarrfikësve në Rahovec, si një grup që vazhdimisht japin kontribut. Në bazë të kushteve që i kanë dhe në bazë të situatës ligjore ku ata janë, është një personel për t’u vlerësuar.

**Burim Krasniqi:** Drejtoreshë, në njërën prej seancave të na përcjellësh një informatë rreth gjendjes së zjarrfikësve në Komunën e Rahovecit. Për kushtet, pajisjet, kërkesat dhe nevojat.

#### **12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim- vendimin për transferimin (harmonizimin) e mjeteve buxhetore 2024:**

**Afrim Limani:** Duke u bazuar në të gjitha mundësitë ligjore, pas analizës së bërë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në pozicionin e pagave, kemi konstatuar se në disa programe kemi tepriçë të mjeteve deri në fund të vitit fiskal. Kjo tepriçë e kap vlerën prej 484.184€. Propozimi ynë është që kjo vlerë të bartet për muajin nëntor dhe dhjetor në kategorinë e pagave, kryesisht te arsimit fillor, sepse aty jemi minus si rezultat i kontratës kolektive, në vlerë prej 1.622.000 dhe kur e shtojmë këtë vlerë të propozimit atëherë kjo vlerë bëhet 1.144.000€. Fatura mujore për paga është 867.000€, që i bie deri në 80% kemi hapësirë për mbulimin e pagave.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, për shkak të kontratës kolektive, pa paga ka mbetur sektori i arsimit, në muajin nëntor dhe dhjetor, apo jo? Nëse këto mjete barten, a mbulohen pagat e nëntorit dhe dhjetorit, apo përsëri mbetet sfida muaji dhjetor? Nëse jo, cilat janë veprimet që duhet t’i ndërmer komuna apo kuvendi që secili sektor publik mos të mbetet pa paga?

**Defrim Kafexhiu:** A përballen edhe komunat tjera me situata të tilla? Si në këtë rast, te harmonizimi i buxhetit në paga dhe mëditje. Kur është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2024, a ka dalë jashtë planifikimit kjo, apo është brenda kornizave, apo duhet të krijohet zgjidhje patjetër për çështjen e kësaj kategorie të arsimit?

**Hasan Përboqi:** E falënderoj drejtorin për këtë përgatitje të këtij dokumenti. Iliri po hidhërohet kur po ju përgëzoj, por me të vërtetë kjo lëvizje strategjike është për t'ju përgëzuar. Me këtë lëvizje janë bërë dy goditje: E para është që mos të bllokohen me paga nëpunësit publikë dhe e dyta është që këto para mos të shkojnë në suficit. Këtë lëvizje duhet ta marrin përbazë edhe komunat tjera.

**Afrim Limani:** Faleminderit Hasan, ti tregove diçka që e kemi përgatitur bashkë këtë strategji! Burim, unë e ndava me ju një informatë shumë të detajuar. Ne i kemi bërë disa lëvizje të mira, duke e shfrytëzuar të drejtën për harmonizim të pagave dhe jemi bazuar kryesisht në ligjin e financave publike dhe përgjegjësi, neni 15, pika 8. Përmbaruesi për kontratën kolektive deri më tani i ka marrë 1.6 milionë dhe me të njëjtën shumë të mjeteve jemi deficit në pozicionin e pagave. Në anën tjetër, i kemi tepricë të mjeteve 482.000€ dhe deficiti mbetet 1.100.000€. Fatura mujore për Komunën e Rahovecit është 860.000€ dhe faktikisht i bie që nëse e bëjmë këtë harmonizim, 70% të pagave për muaji nëntor kemi mundësi t'i mbulojmë. Sipas ligjit, për muajin dhjetor do ta bëjmë një kërkesë duke iu adresuar ministrit që, faturën e pagave të muajit dhjetor t'i paguajnë ata. Në anën tjetër, ministri ka të drejtë ta bëjë transferin e mjeteve me vendim të tij. Sa i përket pyetjes së Defrimit, të them të drejtën ka edhe plot komuna të tjera, të cilat kanë vështirësi shumë më të mëdha se komuna jonë.

**Kryetari:** E falënderoj drejtorin e Financave. Bëhet fjalë për një koordinim të mirë me thesari dhe me departamentin për buxhet. Ne po e bëjmë një veprim, që nëse e kemi të munguar, rreziqet janë më të mëdha. Përgjegjëse për paga për muajin dhjetor është qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave. Sipas veprimeve ligjore, ne jemi mjaft të koordinuar me thesarin. Për kundër komunave tjera, komuna jonë është më pak e dëmtuar. Ne jemi duke e eliminuar suficitin, është e vërtetë ajo që e tha Hasani dhe me këtë veprim së paku për një muaj kemi mbulueshmëri, si dhe në anën tjetër urdhrat përmbarimore i kemi shtyer për tremujorin e vitit të ardhshëm. Sipas ligjit me financat e pushtetit lokal dhe përgjegjësitë, komunat nuk kanë të drejtë të planifikojnë buxhet për kontratën kolektive dhe këtë problem duhet ta zgjidh vetëm qeveria e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh se cila parti është në qeveri. Ju ftoj ta votoni këtë pikë, sepse është veprimi më normal, më i dosmosdoshëm dhe më i mundshëm.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e vendosim në votim pikën e fundit të rendit të ditës. Kush është për?... Kundër?... Konstatohet që me shumicë votash (24) aprovohet. Duhet iu falënderuar për vëmendjen, shihemi në mbledhjet e radhës.


**Procesmbajtësi:**

**Albion Krasniqi**

**K R Y E S U E S I:**

**Arbër Zenuni**

## **PROCESVERBAL**



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme-Odeljenje za Procenu Nepokretnosti-  
Immovable Property Appraisal Department

<b>DATË/A:</b>	16.9.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	/2024
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Smajl LATIFI, Kryetar i Komunës, Rahovec Afrim LIMANI, Drejtor për Buxhet dhe Financa Njomeza FAZLIU, Menaxhere e Zyrës së Tatimit në Pronë
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>CC:</b>	Hekuran MURATI, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve Arton AHMETI, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Albana SHALA BUNJAKU, Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme Vllaznim FERATAJ, Ud. Udhëheqës i Divizionit DVPPTP
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Prona Bujqësore dhe Pyjore</b>

### Të nderuar/a,

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ka nxjerrë raportin për Komunën e Rahovecit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, për kategorinë e pronave Bujqësore dhe Pyjore në kuadër të të cilit janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunës, në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF-NR. 08/2019 për Metodologjinë e Vlerësimit për Qëllime të Tatimit në Pronë, neni 19, Nivelet e Vlerave.

Raporti i vlerësimit të përgjithshëm gjithashtu është nxjerrë pas kryerjes së vlerësimit për të përcaktuar nivelet e vlerave për kategoritë e pronave;

- Pronë Bujqësore, Kategoria e Vlerës: Arë, Kullosë, Livadh, Pemishte, Vresht, Objekt bujqësor për gjënë e gjallë, Ahur/Kotec, Hurdhë peshqish, Objekt tjetër bujqësor,
- Pronë Pyjore, Kategoria e Vlerës: Parcelë pyjore, Parcelë pyjore-malore,

Këto kategori janë të përcaktuara në përputhje me nenin 5 të UA MF-Nr. 08/2019 për Metodologjinë e Vlerësimit për Qëllime të Tatimit në Pronë, neni 19, Nivelet e Vlerave.

Gjatë këtij cikli të vlerësimit të përgjithshëm të pronave të paluajtshme, janë përdorur metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe metoda e kostos.

Me metodën e krahasimit të shitblerjeve janë analizuar kontratat e shitblerjeve të cilat janë përfaqësuese për llojin e pronave që vlerësohen.

Ndërsa me metodën e kostos, kemi marrë përlllogaritjen e kostos për m<sup>2</sup>, për objektet të cilat janë vlerësuar.

Si rrjedhojë në mungesë të shitjeve në disa raste, janë bërë anketa me qytetar lokal të zonave aktuale, janë zhvilluar takime me përfaqësues të komunave për të marrë opinionet/sugjerimet e tyre rreth nivelit të vlerave, intervista me agjentë të shitjes, intervista me zyrtar bankash, vlerat e pronave që janë shpronësuar, ofertat në shitje si dhe informacione tjera relevante të tregut.

Po ashtu në mungesë të shitjeve në disa raste përveç derivimit të vlerave kemi aplikuar edhe qasjen e simulimit të tregut duke aplikuar koeficient për zona dhe nivele të vlerave për të derivuar nivelin e vlerës nga kategoritë kryesore të vlerës në kategoritë tjera.

Nivel bazë i vlerës është përcaktuar për këto kategori të vlerave:

- Bujqësore: Arë, Objekt bujqësor për gjënë e gjallë,
- Pyjore; Parcelë pyjore,

Nivel i derivuar i vlerës është përcaktuar për këto kategori të vlerave:

- Bujqësore; Kullosë, Livadh, Pemishte, Vresht, Ahur/Kotec, Hurdhë peshqish, Objekt tjetër bujqësor,
- Pyjore; Parcelë pyjore – malore,

Për qëllime të tatimit në pronë, aplikohet vlerësimi në masë i pronave të paluajtshme, ku pronat brenda një zone të caktuar gjeografike, të së njëjtës kategori vlere, kanë vlera tregu të përafërta e që nënkupton se niveli i vlerës është i njëjtë në atë zone vlere të caktuar.



Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm (bashkangjitur kësaj shkrese) përmban informacionin si vijon:

- emrin e komunës;
- datën e nxjerrjes;
- nivelin\ nivelet e vlerës\ vlerave për çdo zonë vlere;
- hartat e zonave të vlerave; dhe
- një përshkrim të çdo zone vlere.

Me respekt!



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*  
*Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labor and Transfers*

---

*Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme-Odeljenje za Procenu Nepokretnosti-*  
*Immovable Property Appraisal Department*

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM**  
**PRONAT BUJQËSORE DHE PYJORE**

**KOMUNA RAHOVEC**

---

Prishtinë, 16.09.2024

[mfpt.rks-gov.net](http://mfpt.rks-gov.net)

## TERMINOLOGJIA E PËRDORUR NË RAPORTIN MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM

**Vlerësim i përgjithshëm** - nënkupton procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, përmes të cilit vlerësohen brenda një periudhe të caktuar kohe, me ndihmën e një metodologjie standarde dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara të tregut dhe të dhënave të tjera të nevojshme, të gjitha pronat e paluajtshme në të njëjtën kategori prone;

**Vlerë e tregut** - nënkupton shumën e përafërt të vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehej në datën e vlerësimit, mes një shitësi dhe blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim;

**Shitblerje përfaqësuese** - Një kontratë shitblerje konsiderohet përfaqësuese nëse plotëson kriteret e mëposhtme: (i) Shitblerja është bërë në një treg konkurrues; (ii) Si blerësi ashtu edhe shitësi kanë vepruar me vetëdije, me maturi, me vullnet dhe pa detyrim, nuk kanë lidhje me njëri tjetrin e nuk kanë vepruar në ndonjë mënyrë që mund të ketë ndikuar çmimin; (iii) Prona nuk është e pazakontë për tregun në fjalë;

**Objekt** - nënkupton një ndërtesë, stabiliment, strukturë, send aksesor, mbi ose nën sipërfaqen e tokës, që është e/i trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokën ose objektin, përfshirë ndërtimet notuese të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën;

**Parcelë** - nënkupton një pjesë të sipërfaqes së tokës me kufij të përcaktuar, e cila ndodhet brenda një zone kadastrale dhe është e regjistruar në regjistrat kadastral si parcelë me një numër unik;

**Kategori vlere** - nënkupton një kategori të caktuar që përfshin prona të paluajtshme që shfrytëzohen në mënyrë të ngjashme, të klasifikuara dhe grupuara bashkë për qëllime të vlerësimit. Kategoria e vlerës është nën - ndarje e kategorisë së pronës;

**Zonë vlere** - nënkupton një zonë të caktuar gjeografike ku prona të paluajtshme të krahasueshme, të së njëjtës kategori vlere, kanë vlera tregu të përafërta;

**Niveli bazë i vlerës** - nënkupton vlerën e një metri katror (1 m<sup>2</sup>) të një prone standarde në një zonë vlere të caktuar;

**Nivel i derivuar i vlerës** - nënkupton niveli i vlerës i cili caktohet bazuar në: (i) një nivel bazë të vlerës të së njëjtës kategori vlere nga një zonë specifike e vlerës në Komunë me ndihmën e një koeficienti të zonës së vlerës; ose (ii) një nivel bazë të vlerës të një kategorie tjetër vlere në të njëjtën kategori prone me ndihmën e një koeficienti të kategorisë së vlerës;

**Pronë bujqësore** - nënkupton çdo pronë të paluajtshme e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për qëllime bujqësore;

**Arë** - nënkupton një njësi parcele e cila është e përshtatshme për lërim dhe kultivim të kulturave bujqësore;

**Kullosë** - nënkupton një njësi parcele e cila ndodhet zakonisht në lartësi të mëdha mbidetare dhe është e mbuluar kryesisht me bar. Kullosa nuk është e përshtatshme për lërim, kultivim të kulturave bujqësore dhe kositje-lidhje të sanës por e përshtatshme për kullotjen e bagëtive;

**Livadh** - nënkupton një njësi parcele e cila ndodhet zakonisht në lartësi më të ulëta mbidetare se kullosa dhe është e mbuluar kryesisht me bar. Livadhi nuk është i përshtatshëm për lërim dhe kultivim por mund të shfrytëzohet për kullotjen e bagëtive dhe kositjen lidhjen e sanës;

**Pemishte** - nënkupton një njësi parcele e cila është mbjellë në shkallë të madhe me pemë dru-frutor dhe që shfrytëzohet zakonisht për prodhim komercial të frutave;

**Vresht** - një njësi parcele e cila është mbjellë në shkallë të madhe me rrush dhe që shfrytëzohet zakonisht për prodhim komercial të rrushit për verë; dhe;

**Objekt bujqësor për gjënë e gjallë** - nënkupton një njësi objekti e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për rritjen apo mbajtjen e kafshëve dhe/ose shpendëve shtëpiake për prodhimin e të mirave, dhe/ose shërbimeve në shkallë të madhe, kryesisht për qëllime komerciale;

**Ahur/Kotec** - nënkupton një njësi objekti e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për rritjen apo mbajtjen e kafshëve dhe/ose shpendëve shtëpiake për prodhimin e të mirave në shkallë të vogël, me qëllim plotësimin e nevojave të anëtareve të familjes;

**Hurdhë peshku** - nënkupton një njësi objekti e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për rritjen apo mbajtjen e peshqve për prodhimin e të mirave dhe/ose shërbimeve;

**Objekt tjetër bujqësor** - nënkupton një njësi objekti e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për qëllime bujqësore, përveç rritjes apo mbajtjes së kafshëve shtëpiake, shpendëve dhe peshqve;

**Pronë pyjore** - nënkupton çdo pronë të paluajtshme e cila shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për qëllime pyjore;

**Parcelë pyjore** - nënkupton një njësi parcele e cila është e përshtatshme për prodhim komercial pyjor apo shfrytëzim shtëpiake;

**Parcelë pyjore-malore** - nënkupton një njësi parcele me kapacitet të ulët prodhimi e cila nuk mund të shfrytëzohet për prodhim pyjor apo shfrytëzim shtëpiake;

## RAPORT MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM

Komuna: RAHOVEC

Data e nxjerrjes së raportit: 16.09.2024

Kategoria e pronës: Pronë Bujqësore

Tipi i njësisë: Parcela Bujqësore

- Niveli/Nivelet e vlerës/vlerave në çdo zonë vlere.

Nivelet e Vlerave (€/m <sup>2</sup> )					
RAHOVEC					
PARCELA BUJQËSORE					
Numri i Zonës së Vlerës	Kategoria e Vlerës				
	Arë	Kullosë	Livadh	Pemishte	Vresht
1601	€ 5.00	€ 3.50	€ 4.00	€ 5.00	€ 5.00
1602	€ 1.00	€ 0.70	€ 0.80	€ 1.00	€ 1.00
1603	€ 3.00	€ 2.10	€ 2.40	€ 3.00	€ 3.00
1604	€ 2.80	€ 2.00	€ 2.20	€ 2.80	€ 2.80
1605	€ 3.50	€ 2.50	€ 2.80	€ 3.50	€ 3.50


Tipi i njësisë: Objekte Bujqësore

- Niveli/Nivelet e vlerës/vlerave në çdo zonë vlere.

Nivelet e Vlerave (€/m <sup>2</sup> )				
RAHOVEC				
OBJEKTE BUJQËSORE				
Numri i Zonës së Vlerës	Kategoria e Vlerës			
	Objekt bujqësor për gjënë e gjallë	Ahur/Kotec	Hurdhë peshku	Objekt tjetër bujqësor
1601	€ 120.00	€ 60.00	€ 120.00	€ 60.00
1602	€ 60.00	€ 30.00	€ 60.00	€ 30.00
1603	€ 80.00	€ 40.00	€ 80.00	€ 40.00
1604	€ 80.00	€ 40.00	€ 80.00	€ 40.00
1605	€ 90.00	€ 45.00	€ 90.00	€ 45.00



## Harta e zonave të vlerave për Prona Bujqësore



## **PËRSHKRIMI I ZONAVE TË VLERAVE**

**Numri i zonës së vlerës:** 1601

**Kategoria e Pronës:** Pronë Bujqësore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në pjesën qendrore të komunës, duke përfshirë komplet qytetin me dalje kryesore, vreshtat në krahun perëndimor të tranzitit dhe një pjesë të arave dhe vreshtave në krahun jug-lindor të qytetit. Karakteristikë e zonës janë vreshtat në afërsi të qytetit dhe bodrumet e verës.

**Kategoria e Vlerës:** Arë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e Vlerës:** Objekt bujqësor për gjënë e gjallë.

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e kostos dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës:** 1602

**Kategoria e Pronës:** Pronë Bujqësore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet krejtësisht në pjesën periferike të komunës, si dhe është e vendosur në krahun veri-lindor të saj. Identifikohet kryesisht si zonë periferike, kryesisht terren pyjor, duke prekur në bjeshkë të Zatriqit dhe Opterushës.

**Kategoria e Vlerës:** Arë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e Vlerës:** Objekt bujqësor për gjënë e gjallë.

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e kostos dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës:** 1603

**Kategoria e Pronës:** Pronë Bujqësore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në krahun jug-lindor të komunës, duke përfshirë daljen e qytetit në drejtim të Hoqës së Madhe, vendin e quajtur paskidol, më pas përfshinë rreth gjysmën e terrenit të zonave kadastrale Hoqë e Madhe, Zoçishtë dhe Brestoc. Zona karakterizohet me ara dhe vreshta, si dhe fusha të hapura tokë punuese.

**Kategoria e Vlerës:** Arë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e Vlerës:** Objekt bujqësor për gjënë e gjallë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e kostos dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës:** 1604

**Kategoria e Pronës:** Pronë Bujqësore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në krahun veri-perëndimor të komunës, duke filluar nga vendi i quajtur rimnik, për të vazhduar deri në kufirin administrativ të komunës së Klinës, më saktësisht në zonat kadastrale Potoçan i Epërm, Potoçan i Poshtëm, Nashpall, Vrajak, Drenoc, Ratkoc, Bratatin, Dejnë, Pastasellë, Polluzhë, Dobidol, Çifllak, Petkoviç, Kaznik, Kramoviç, dhe Mrasor. Karakteristikë e zonës janë fusha të hapura, fshatrat, tokë me komasacion dhe vreshtat.

**Kategoria e Vlerës:** Arë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e Vlerës:** Objekt bujqësor për gjënë e gjallë

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e kostos dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës: 1605**

**Kategoria e Pronës: Pronë Bujqësore**

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në krahun jugor të komunës dhe përfshirë zonat kadastrale: Retijë, Hoçë e vogël, Nagavc, Krushë e madhe, Celinë, Bellacërkë, Bërnjak, Xërxë, Gexhë, Radostë, Ratkoc, Sapniq, Bërnjak, një pjesë Brestovc, Rahovec, Pataçan I Epërm dhe Pataçan i Poshtëm. Karakteristikë e zonës janë arat dhe fusha të hapura me tokë punuese, fshatrat, tokë me komasacion, etj.

**Kategoria e Vlerës: Arë**

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e Vlerës: Objekt bujqësor për gjënë e gjallë**

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e kostos dhe simulimi i tregut.

**Kategoria e pronës:** Pronë Pyjore


**Tipi i njësisë:** Parcela Pyjore

- Niveli/Nivelet e vlerës/vlerave në çdo zonë vlere.

<b>Nivelet e Vlerave (€/m<sup>2</sup>)</b>			
<b>RAHOVEC</b>			
<b>PARCELA PYJORE</b>			
<b>Numri i Zonës së Vlerës</b>	<b>Kategoria e Vlerës</b>		
		<b>Parcelë pyjore</b>	<b>Parcelë pyjore-malore</b>
<b>1601</b>	€	1.40	€ 0.30
<b>1602</b>	€	1.00	€ 0.20
<b>1603</b>	€	1.20	€ 0.20



### Harta e zonave të vlerave për Prona Pyjore





## **PËRSHKRIMI I ZONAVE TË VLERAVE**

**Numri i zonës së vlerës:** 1601

**Kategoria e Pronës:** Pronë Pyjore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në pjesën qendrore të komunës, më saktësisht përfshin qytetin me periferinë e tij, si dhe përfshinë terren të zonave kadastrale Hoçë e madhe, Brestoc, Hoçë e vogël dhe Zoçishtë. Identifikohet me terrene të caktuara të maleve të shpërndara brenda saj.

**Kategoria e Vlerës:** Parcelë Pyjore

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës:** 1602

**Kategoria e Pronës:** Pronë Pyjore

**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës shtrihet në krahum verior të komunës, më saktësisht është e vendosur përgjatë kufirit komunal Malishevë. E njëjta përfshinë terren duke prekur në zonat kadastrale Çifllak, Kramovik, Mrasor, Petkoviç, Kaznik, Polluzhë, Pastasellë, Senoc, Drenoc, Zatriç, Rahovec, Hoçë e madhe, Zoçishtë dhe Opterushë. Identifikohet kryesisht si zonë rurale me vendbanime, si dhe terrene me bjeshkë, male dhe pyje brenda saj.

**Kategoria e Vlerës:** Parcelë Pyjore

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Numri i zonës së vlerës:** 1603

**Kategoria e Pronës:** Pronë Pyjore


**Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës është e shtrirë në pjesën jugore dhe lindore të komunës, më saktësisht fillon shtrirjen nga zona kadastrale Zoçishtë, Opterushë, Retije, më pas vazhdon në drejtim të perëndimit duke përfshirë zonat kadastrale Hoçë e vogël, Nagave, Krushë e madhe, Celinë, Bërnjak, Bellacërkë, një pjesë Rahovec, Bërnjak, Xërxë, Gexhë, Sapniç, Potoçan i poshtëm, Potoçan i epërm, Radostë, Ratkoc, Dejnë, dhe vazhdon si drejtim deri te zonat kadastrale Dobidol dhe Polluzhë. Kryesisht identifikohet si terren bujqësor, me disa male të shpërndara brenda zonës.

**Kategoria e Vlerës:** Parcelë Pyjore

- **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i tregut.

**Përgatitur nga:**

Pajtesa Bytyqi – Zyrtare e Lartë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

  
\_\_\_\_\_

Herolind Osmani – Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

  
\_\_\_\_\_

Vllaznim Vuçitërna – Ekspert i Gjeodezisë

  
\_\_\_\_\_

Vllaznim Ferataj – Ud. Udhëheqës i Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për  
Tatimin në Pronë

  
\_\_\_\_\_

Albana Shala Bunjaku – Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

  
\_\_\_\_\_

2024

# Informatë - Drejtoria e Bujqësisë



JANAR - NËNTOR

11/13/2024

## Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....	3
Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars .....	3
Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor .....	4
Pagesat Direkte - Subvencionet 2024.....	5
Qent Endacak: .....	7
Aktivitetet në periudhën: Korrik, Gusht, Shtator .....	7
Festat me karakter bujqësor: Agrofesta dhe Hardhfest 2024.....	8
Aktivitetet në periudhën: Tetor, Nëntor. ....	9
Projektet e investimeve kapitale .....	10
Kanalet e kullimit .....	10
Kontratat e reja .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pastrimi i përrrenjëve .....	10
PËRFUNDIM .....	11

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Përmes politikave dhe strategjive tentojmë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas të resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2024, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.


### Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimisht siq janë pranimit dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimit i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **15 janar deri më 13 shkurt 2023**.
- Gjithësej kanë aplikuar **91** blegtorë, me gjithsej: **1,709,950** litra qumësht dhe **522** krerë të viçave për majmëri
- Kemi mbajtur takim me Agjensionin Pyjor, ku dhe ju kemi bartur kompetencat për stafin e Pylltarisë.
- E kemi përfunduar Cash planin për vitin 2024.
- Është nënshkruar kontrata “Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia të hardhisë së rrushit”
- Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese “Agro Celina”, në vitin 2024 e cila do të furnizojë bujqit me Fidane dhe inpute tjera për kulturën e trangullit “Kornishan” Përmes





# Informatë – Drejtoria e Bujqësisë | janar-nëntor 2024

kësaj marrëveshje do të mbulohen: Fidanet cilësore të trangullit, Plehërimi dhe Riplehrimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi ( Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë.

- Gjatë muajit janar për shkak të erës së fuqishme, kanë ndodhur disa dëme, kemi pranuar informata nga disa fermerë që iu janë shkaktuar dëme dhe të cilëve më pas iu kemi pranuar kërkesat e tyre dhe komisioni ka dalë në terren për verifikim të dëmeve.
- Poashtu gjatë muajit janar ne si Drejtori dhe si Komune e Rahovecit e kemi përmbyllur raportin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2023 duke proceduar edhe ne Kuvendin e Komunës

- Në sektorin e blegtorisë kemi ndërmarrur aksion për trajtim, kontroll dhe vaksinim të bagëtive të trasha dhe bagëtive të imëta, veterinari i angazhuar ka kryer vaksinimin e bagëtive 1,915 krerë lopë dhe rreth 7,500 dele. Gjithsej janë vizituar 121 ferma blegtorale.



- Nga 6 mars deri më 20 mars , ka qenë e hapur thirrja për aplikim: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit. Gjithsej kanë aplikuar 495 fermerë Vreshtarë.



## Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor

- Është formuar komisioni për verifikimin e aplikacioneve për thirrjen :Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, komisioni ka publikuar raportin dhe listën e 495 përfituesëve të preparatit.
- Poashtu është bërë rishpallja e thirrjes: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, e cila ka qenë e hapur nga data 24 maj deri

# Informatë – Drejtoria e Bujqësisë | janar-nëntor 2024

më 3 qershor 2024. Komisioni ka formuar sërish raport dhe ka publikuar listën me 82 përftues. Përfituesit e këtij preparati janë njoftuar dhe janë furnizuar.

- Gjatë muajit muajit maj është hapur thirrja: Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL, afati i aplikimit ka qenë nga data: **02.05.2024** deri më **22.05.2024**. Gjithsej kemi pranuar 1,134 aplikacione. Komisioni i ka verifikuar aplikacionet, është shpallur lista përfituese dhe fermerët përfitues janë duke e kryer participimin prej 20%.
- Nga data **31.05.2024** deri më **14.06.2024** ka qenë e hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e festivaleve tradicionale dhe kulturore si: Festa e Vjeljes së Rrushit – 7 shtatori dhe Agrofesta për vitin 2024. Është formuar komisioni dhe është zgjedhur OJQ përfituese.

## Pagesat Direkte - Subvencionet 2024

Më **13 mars** është hapur aplikimi për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Për sektorët, të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2024, afati për aplikim ka qenë i hapur deri më **12 prill 2024**, mirëpo pas kërkesës tonë, është zgjedhur deri më **29 prill 2024**.

Ne si drejtori e BPZHR-së jemi angazhuar të mobilizohemi me zyret në Krushë të Madhe dhe Ratkoc ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyret e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha poashtu kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqëve.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2024 është **3,099** ku krahasuar me vitin 2023 kemi **20** aplikacione më pak.

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna më pastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

Tabela me të dhënat e kulturave bujqësore të ndara me sektorë dhe të shprehura në sipërfaqe me ha, për të cilat kanë aplikuar fermerët e Komunës tonë.

Të dhënat e fermerëve		2022	2023	2024	Diferenca 2024/2023
Sektori i Lavërtarisë		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	Sip. në ha
1	Grurë	2,006.21	<b>2,743.61</b>	<b>2520.53</b>	-223.08
2	Misër	1,578.94	<b>1,943.60</b>	<b>1875.96</b>	-67.64
3	Elb	4.05	<b>1.12</b>	<b>6.5</b>	5.38
4	Tersher	122.04	<b>80.01</b>	<b>99.9</b>	19.89
5	Theker	0.00		<b>1.72</b>	1.72
Gjithsej		<b>3,711.24</b>	<b>4,768.34</b>	<b>4,504.61</b>	-263.73

# Informatë - Drejtoria e Bujqësisë | janar-nëntor 2024

Sektori i Vreshtarisë		Sip ne ha	Sip në ha	Sip në ha	
	Lloji i kulturës				
1	Rrush	2,322.21	2,274.57	2,216.29	-58.28
2	Fidane të hardhisë	149,900.00	124,000.00	127,000.00	3,000.00
Sektori i Perimkulturës		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Speca	695.30	616.41	695.30	78.89
2	Domate	11.48	9.66	17.41	7.75
3	Qepë	149.76	186.78	235.47	48.69
4	Hudhër	25.56	20.37	14.66	-5.71
5	Patate	166.35	189.22	260.02	70.80
6	Tranguj	0.43	0.74	0.61	-0.13
7	Karota	7.65	7.14	6.38	-0.76
8	Rrepkë	0.00	0.49	0.00	-0.49
9	Brokuli	0.25	0.00	0.30	0.30
10	Fasule	0.46	1.90	2.70	0.80
11	Pangjar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	144.20	70.65	134.97	64.32
13	Lulelakër	10.82	10.23	8.06	-2.17
14	Presh	0.20	0.00	0.57	0.57
15	Spinaq	0.84	0.48	0.85	0.37
16	Marule	0.64	0.90	1.68	0.78
<b>Gjithsej</b>		<b>1,213.94</b>	<b>1,114.97</b>	<b>1,378.98</b>	<b>264.01</b>
Kungullore		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Shalqinj	164.68	171.68	353.99	182.31
2	Pjepër	100.24	84.49	98.71	14.22
3	Kunguj	11.82	6.58	23.80	17.22
4	kungull i Gjelbert	302.84	160.41	242.77	82.36
<b>Gjithsej</b>		<b>579.58</b>	<b>423.16</b>	<b>719.27</b>	<b>296.11</b>
Sektori i Pentarisë		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Dardhë	6.63	7.81	3.46	-4.35
2	Dredhëz	2.72	2.09	1.19	-0.90
3	Kumbull	54.86	62.65	49.92	-12.73
4	Mollë	8.96	10.26	8.70	-1.56
5	Arra	73.90	95.15	92.86	-2.29
6	Lajthi	10.77	9.22	9.52	0.30
7	Ftoj	4.17	3.86	3.86	0.00
8	Mjeder	0.53	0.00	0.00	0.00
9	Pjeshkë	2.69	3.27	2.96	-0.31
<b>Gjithsej</b>		<b>165.23</b>	<b>194.31</b>	<b>172.47</b>	<b>-21.84</b>
Sektori i Blegtorisë dhe Shpezetarisë					
1	Bletë	4,245.00	4,793.00	5,276.00	483.00
2	Lopë	1,938.00	1,953.00	1,966.00	13.00
3	Dhi	248.00	167.00	150.00	-17.00
4	Dele	7,226.00	7,396.00	5,244.00	-2,152.00
5	Pula vojëse	59,100.00	60,260.00	52,000.00	-8,260.00

# Informatë – Drejtoria e Bujqësisë | janar-nëntor 2024

Nr.	Lloji I kulturës	Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	BMA	16.51	8.54	10.96	2.42
					0.00
Perime në Serra					0.00
1	Perime	24.26	27.21	28.77	1.56

Nga tabela e prezantuar me lartë mund të vërejm se këtë vit kemi rritje në sektorin e perimkulturës, konkretisht të kultura e Specit, Shalqinit, Patates, Lakrës dhe qepës, ndërsa zbritje në sipërfaqet e mbjellura kemi të drithërat si: Grurë dhe Misër.

## Qent Endacak:

Ka vazhduar aksioni për trajtimin e qenve endacak gjatë gjithë kësaj periudhe raportuese, në disa lokacione të komunës sonë, ku shpresojmë që deri në kohën e ardhjes së mërgimtarëve të kemi gjendje më të mirë në terren. Poashtu jemi duke bashkëpunuar me përfaqësues të KFOR-it LMT lidhur me përkrahje për trajtim të qenve endacak nga CIMIC-u gjerman, ku jemi në pritje të një përgjigje të një projekti që kemi aplikuar.

## Aktivitetet në periudhën: Korrik, Gusht, Shtator

Muaji korrik është edhe muaji i korrje-shirjeve, ku është formuar komisioni për përcjelljen e këtij procesi, i cili ka dalur në terren dhe dhe në bazë të dhënave këtë vit rendimenti është ka qenë i kënaqshëm dhe mesatarja për një hektar është sillur nga 4,000 kg deri në 6,000 kg. Poashtu raportin për fushatën e korrje-shirjeve e kemi përcjell edhe në MBPZHR

Gjatë muajit korrik ka vazhduar nënshkrimi i kontratave me fermer si dhe pjesa e participimit prej 20%.

Po ashtu është bërë shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të parë, sasia e shpërndarë është 5,000 thasë, për 547 fermerë.



Nga 01.08.2024- 01.09.2024 ka qenë e hapur thirrja nga MBPZHR-ja për Litrazhë të qumështit të dorëzuar, Sasinë e grurit të dorëzuar dhe për Pleh Artificial në kuadër të MBPZHR-së. Gjithsej kane aplikuar 804 fermerë.




Gjatë muajit shtator është publikuar thirrja “Përkrahja e Fermerëve me Serra për fermerët e komunës së Rahovecit” e cila ka qenë e hapur nga data 17.09.2024 deri më 01.10.2024, ku gjithsej kanë aplikuar 135 fermerë. .

## **Festat me karakter bujqësor: Agrofesta dhe Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest 2024**

---


Gjatë muajve Gusht dhe Shtator është bërë organizimi i festave me karakter bujqësor si Agrofesta dhe festa e vjeljes së rrushit- Hardhfest

**Agrofesta** është mbajtur me 3 dhe 4 Gusht, në Krushë të Madhe, ku janë promovuar prodhimet bujqësore, produktet e ndryshme bujqësore, ushqimet tradicionale etj.





Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest është mbajtur me 6, 7 dhe 8 Shtator në Rahovec, ku janë zhvilluar shumë aktivitete dhe ka pasur vizitor nga vende të ndryshme.



Padyshim që ky edicion ka arritur sukses të jashtëzakonshëm duke i tejkaluar pritshmërit për faktin se një numër i madh i vizitorëve kanë qenë të huaj.

## Aktivitetet në periudhën: Tetor, Nëntor.

### ‘Përkrahja e Fermerëve Blegtor’

Është publikuar thirrja “Përkrahja e Fermerëve Blegtor”, nga data 24.09.2024 deri më 08.10.2024, gjithsej kanë aplikuar 247 fermerë, të gjithë aplikuesit janë shpallur përfitues dhe pagesat janë ekzekutuar me 29 tetor. Përmes kësaj përkrahje për herë të parë në këtë formë janë shpërndarë **57,700€** për 247 fermer blegtor e ku janë përfshirë edhe fermerët e vegjël të cilët nuk përfshihen në skemën e subvencioneve të MBPZHR-së.

### Ndërtimi i Serrave për fermerë

Është publikuar lista e përfitueseve për serra ku gjithsej kanë përfituar **48** fermerë.

Afati i ankesave ka qenë i hapur 7 ditë nga 14.10.2024- 21.10.2024, me ankesa kanë përfituar serra edhe **42** fermerë.

#### Përkrahja e fermerëve me serra

Lista e parë

Lista me ankesë

#### Serra 3 ari

22 përfitues

35 përfitues

#### Serra 5 ari

26 përfitues

7 përfitues

Është duke u kryer participimi 20 % për serra, si dhe ndërtimi i tyre te fermerët përfitues.

Gjatë muajit tetor ka vazhduar nënshkrimi i kontratave me fermer si dhe pjesa e participimit prej 20%, për pleh artificial.

Po ashtu është bërë shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të dytë, sasia e shpërndarë është **4,000** thasë për **375** fermerë.

Poashtu presim të furnizohemi edhe pjesën e fundit me pleh Artificial ku shpresojmë që brenda muajit nëntor të përfundoj edhe shpërndarja te fermerët përfitues me **1,020** thasë.

## Projektet e investimeve kapitale

### Kanalet e kullimit

**Kanali i Kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc** – Ka përfunduar edhe ndërtimi urës në pjesën e poshtme të fshatit që është pozicion i veçant në projekt. Tani është duke u bërë rregullimi i shtrazit afër kësaj ure dhe pas përfundimit të këtyre ndërhyrjeve përfundojnë edhe punimet në këtë projekt. Sfid mbetet mirëmbajtja dhe pastrimi.

**Kanali i Kullimit nga Shtavica deri ne Fortese-** Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit aktualisht është duke u betonuar baza e kanalit si dhe ndërtimi i skarpateve, poashtu në këtë periudhë është ndërtuar edhe ura e fundit e paraparë me projekt te mulliri Hoxha. Ka mbetur edhe segmenti i fundit në gjatësi prej 850 m, por në për këtë periudhë punimet janë ndërprerë pasi që edhe kushtet atmosferike janë te pafavorshme e poashtu edhe mungesë e mjeteve financiare.

**Kanali i Kullimit në Çifllak-** Ka përfunduar edhe ndërtimi i urës në qendër të fshatit dhe janë duke vazhduar punimet në segmentin e fundit në drejtim të drinit të bardhë.

**Kanali i Kullimit Fortesë – Celinë** – Ky projekt ka përfunduar dhe tani ka filluar ndërtimi i fazës së dytë i cili do të shkarkojë ujërat në drejtim të lumit drini i bardhë, ky projekt financohet me grantin e performancës. Aktualisht është duke u punuar në ndërtimin e kanaleve që bartin ujin e pjesës kodrinoare dhe do të vazhdohet me kanalën për shkarkim në kanalën e fshatit Celinë.

**Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore** - ka filluar zbatimin e kontratës në trajtimin e rrugëve fushore, kanë përfunduar segmentet e planifikuara në fshatrat: Zoqisht, Retijë, Retijë e Poshtëme aktualisht është duke u punuar në Zonën Kadastrale të qytetit, konkretisht në degëzimet e rrugës Hamoc-Fortesë, poashtu punimet janë duke vazhduar në segmentin Rahovec-Celinë ku do të bëhet edhe ndërlidhja e rrugëve që shkojnë në fshatrat Hoçë e Vogl dhe Nagafc.

### Pastrimi i përrenjëve

Pastrimi i kanaleve dhe përrenjëve ka pasur fokusin kryesor në këtë pjesë të parë të vitit. Kemi intervenuar në shumë lokacione si: Rahovec (rimnik), Nagafc, Zoqisht, Kramovik, Xërxë, në dalje të fshatit Ratkoc, konkretisht te pompa e derivateve DINA-H, poashtu sipas kërkesës se banorëve të fshatit Gexhë e kemi pastruar segmentin ne hyrje të fshatit në mes të fshatit Malësi e Vogel deri më tani i patrajtuar ndonjë herë. Po ashtu janë pastruar përrenjt në Xërxë edhe në Fortesë në disa Segmente.

## PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në kontakt të vazhdueshëm me fermer duke i takuar fermerët në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre e poashtu duke dëgjuar me vëmendje brengat, shqetësimet dhe kërkesat e tyre.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmton kulturat bujqësore.

13.11.2024

Rahovec

DREJTORI I DBPZHR-së  
Berat Duraku



**LIGJI NR. 08/L-224**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN  
E PALUAJTSHME**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË  
PRONËN E PALUAJTSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

**Neni 2**

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9  
Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.
2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.
3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:
  - 3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;
  - 3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;
  - 3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
  - 3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe
  - 3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen.”

### **Neni 3**

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

### **Neni 4**

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

### **Neni 5**

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

## **KAPITULLI II/A**

### **FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023**

#### **Neni 11/A Pranueshmëria**

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.



**Neni 11/B****Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

**Neni 11/C****Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

**Neni 11/Ç****Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

**Neni 6**

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një këst të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

**Neni 7**

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interesi i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

**Neni 8**

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

**Neni 30/A****Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbarimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbarimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

**Neni 9**

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

**Neni 39 /A**  
**Shkalla tatimore tranzitore**

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejné dispozitat e ligjit bazik.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

**Ligji Nr. 08/L-224**  
**27 korrik 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.11.2022 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/24 i datës 00.11.2024 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510008-00268-1.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. \_\_\_\_\_, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
  - 2.2. \_\_\_\_\_, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
  - 2.3. \_\_\_\_\_, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
  - 2.4. \_\_\_\_\_, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
  - 2.5. \_\_\_\_\_, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01 Nr. \_\_\_/24  
Datë:00.11.2024

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-049, nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2023"), nenit 10, nenit 39 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika 2.3 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2024, merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025**

- 1. Miratohet** vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
- 2. Normat** tatimore të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

<b>Kategoria e Pronës</b>	<b>Norma tatimore</b>
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.16 % - propozim 0.10%
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.16 % - propozim 0.10%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.16 % - propozim 0.10%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.12 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.19 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.16 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.16 %

- 3. Për zbatimin** e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 4. Ky vendim** do të fillojë së zbatuari nga data 1 janar 2025.
- 5. Pas miratimit** nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.



*Vendimi u dërgohet:*

- *Ministrisë së Financave,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrës së Tatimit në Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr. \_\_\_\_/24  
Datë: 22.11.2024

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Komuna Rahovec**  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 4911 Nr. i faq./Br.str./No.pg 195  
Data/Datum/Date 04 / 11 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-049, nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2023"), nenit 74, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.9 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, u:

### PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Normat tatimore të cekura në pikën 1 të këtij propozimi janë si në vijim:

Kategoria e pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.16 % - propozim 10%
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.16 % - propozim 10%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.16 % - propozim 10%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.12 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.19 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.16 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.16 %

2. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Sekretaria e Kuvendit dhe kryesuesi i Kuvendit.
3. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





**Komuna Rahovec**  
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec  
Drejtoria për Buxhet dhe Financë  
Odeljenje za Budvet i Finansiie/Department of



## RAPORTI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM PRONAT BUJQËSORE DHE PYJORE

### **Numri i zonës së vlerës 1601**

Kjo zone e vlerës shtrihet në pjesën qendrore të komunës, duke përfshirë komplet qytetin me dalje kryesore, vreshtat në krahun perëndimor të tranzitit dhe një pjesë të arrive dhe vreshtave në krahun jug-lindor të qytetit.

### **Numri i zonës së vlerës 1602**

Kjo zone e vlerës shtrihet krejtësisht në pjesën periferike të komunës, si dhe është e vendosur në krahun very-lindor të saj, si dhe duke prekur në bjeshkë të Zatriqit dhe Opterushës.

### **Numri i zonës së vlerës 1603**

Kjo zone e vlerës shtrihet në krahun jug-lindor të komunës, duke përfshirë daljen e qytetit në drejtim të Hoqës së Madhe, vendin e quajtur paskindol, si dhe përfshinë gjysmën e terrenit të zonave kadastrale Hoqë e Madhe, Zoçishtë dhe Brestovc.

## **Numri i zonës së vlerës 1604**

Kjo zone e vlerës shtrihet në krahun veri-perëndimor të komunës, duke filluar nga vendi i quajtur rimnik, Pataçan i Epërm, Pataçan i Poshtëm, Nashpall, Vrajak, Drenoc, Ratkoc, Bratatin, Dejnë, Pastasell, Polluzhe, Dobidol, Çifllak, Petkoviç, Kaznik, Kramovik dhe Mrasor.

## **Numri i zonës së vlerës 1605**

Kjo zone e vlerës shtrihet në krahun jugor të komunës duke pëfshirë zonat kadastrale: Retijë, Hoqe e Vogël, Nagavc, Krushe e Madhe, Celinë, Bellacerkë, Bërnjak Xërxe, Gexhë, Radoste, Ratkoc, Sapniç, Bërnjak, një pjesë Brestovc, Rahovec, Pataçan i Epërm, Pataçan i Poshtëm.

## Parcelat-Arë

	Viti	Metra katror	Vlera për metër kator	Vlera e parcelës	Përqindja e tatimit	Shuma për pagesë	Ndryshimi në qmim
Zona 1601	2024	10000	5	50000	0.16%	80	
	2023	10000	4.8	48000	0.16%	76.8	
	propozim 2025	50000	5	250000	10.00%	25000	-24920
Zona 1602	2024	10000	1	10000	0.16%	16	
	2023	10000	1	10000	0.16%	16	
	propozim 2025	10000	1	10000	0.10%	10	6
Zona 1603	2024	10000	3	30000	0.16%	48	
	2023	10000	3	30000	0.16%	48	
	propozim 2025	10000	3	30000	0.10%	30	18
Zona 1604	2024	10000	2.8	28000	0.16%	44.8	
	2023	10000	2.8	28000	0.16%	44.8	
	propozim 2025	10000	2.8	28000	0.10%	28	16.8
Zona 1605	2024	10000	3.5	35000	0.16%	56	
	2023	10000	3.5	35000	0.16%	56	
	propozim 2025	10000	3.5	35000	0.10%	35	21

## Parcelat-Vreshtë

	Viti	Metra katror	Vlera për metër kator	Vlera e parcelës	përqindja e tatimit	Shuma për pagesë	Ndryshimi në qmim
Zona 1601	2024	10000	5	50000	0.16%	80	
	2023	10000	4.8	48000	0.16%	76.8	
	propozim 2025	10000	5	50000	0.10%	50	30
Zona 1602	2024	10000	1	10000	0.16%	16	
	2023	10000	1	10000	0.16%	16	
	propozim 2025	10000	1	10000	0.10%	10	6
Zona 1603	2024	10000	3	30000	0.16%	48	
	2023	10000	3	30000	0.16%	48	
	propozim 2025	10000	3	30000	0.10%	30	18
Zona 1604	2024	10000	2.8	28000	0.16%	44.8	
	2023	10000	2.8	28000	0.16%	44.8	
	propozim 2025	10000	2.8	28000	0.10%	28	16.8
Zona 1605	2024	10000	3.5	35000	0.16%	56	



	2023	10000	3.4	34000	0.16%	54.4	
propozim	<b>2025</b>	10000	3.5	35000	<b>0.10%</b>	<b>35</b>	21



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq/Br.str/No.pg 160  
Data/Datum/Date 29.11.2023

Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-049, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2023"), nenit 10, nenit 39 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.11.2023 merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

1. Miratohet vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Normat tatimore të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.16 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.16 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.16 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.12 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.19 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17%
Për njësitë industriale të parcelave	0.16%
Për njësitë industriale të objekteve	0.16 %

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim do të filloj së zbatuari nga data 1 Janari 2024.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Ministrisë së Financave,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrës së Tatimit në Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.160/23**  
**Datë:29.11.2023**





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/4914/24, i datës 5.11.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, në vendin e quajtur krlinski dubovi, me kulturë mal i klasës V, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510008-00268-1, në sipërfaqe prej 400m<sup>2</sup> (katërqind metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 31677m<sup>2</sup> (tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim, i pronës së paluajtshme të Komunës, e cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe t'u jepet mundësia qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij propozimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023 – 2031, me Nr. Prot. 01, Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, ka destinim prodhim tretësor, shërbim tregtar, shërbim të akomodimit dhe të ushqimit.
5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.
6. Prona e paluajtshme në fjalë, nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01-Nr. \_\_\_/24  
Më datë: 22.11.2024

**Arbër Zenuni**  

---

Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, u:

### PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij propozimi është në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, në vendin e quajtur krlinski dubovi, me kulturë: mal i klasës V, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510008-00268-1, në sipërfaqe prej 400m<sup>2</sup> (katërqind metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 31677m<sup>2</sup> (tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe t’u jepet mundësia qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.
5. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa Komunale në bazë mujore.



6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

*Me propozim të njoftohen:*

- *Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,*
- *Sekretaria e Kuvendit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510008-00268-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0043062/24  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 30.10.2024 - 08:48  
Komuna / Opština / Municipality: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Hoxë E Madhe / Velika Hoca / Hoga E Madhe  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71510008-00268-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	31677	11/2009 Regj. i flet. nr. 1/2009		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
KRLINSKI DUBOVI				



**A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area (m <sup>2</sup> )
1	Pjor/shumsko/Forestry	Tokat Pjore/shumsko zemljiste/Forest	Mal I Klases 5/Suma 5 Klase/5th Class Forest	31677

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronis Deo imovine Share quota	Peshkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	<b>Komuna e Rahovecit</b>	600535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHMORËTJE PASHTRIKUT	1/1	11/2009 Regji. i flet nr. 1/2009	





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Hoçë E Madhe

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71510008-00268-1	Parcelë / Parcela / Parcel	31677



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2707

Punoi/Obradio/Created: Elma Shehu Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 31.10.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:05:55





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Rahovec

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 268-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Hoqë e Madhe


Numri i lëndës / Broj predmeta: 121/2024

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1250

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

1	7474050.459	4695285.336
2	7474117.965	4695222.094
3	7474089.002	4695187.566
4	7474028.003	4695244.711



Rilevoi / Snimio: Shaban Hoti  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 34

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_

Data e rilevimit / Datum snimanja: 08/11/2024





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo  
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zashtitu Okoline  
Department for Urbanism, Planning and Environment Protection

Sektori për Urbanizëm  
Odeljenje za Urbanizam

Data:	06.11.2024
Për:	Z. Afrim Oruqi, Drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Nga:	Sekt. i Urbanizmit
Përmes:	Z. Albnor Mullabazi, Drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Lenda / subjekti	Vërtetim Urbanistik
Baza:	Vendimi Nr. 182/24 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031, miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, datë 30.01.2024

Bazuar në kërkesën e Drejtoris për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, nga Komuna e Rahovec, të datës 05.11.2024, për destinim të parcelës sipas Planit Zhvillimor Komunal, për parcelën kadastrale Nr. **00268-1**, nga certifikata nr. **08-942/03-0043062/24**, e datës 22.02.2024, te vendi i quajtur **Krlinski Dubovi**, toka Pyjore, Mal I Klasës 5, pronë **Komuna e Rahovec**, zona kadastrale Hoçë e Madhe.

Vërtetohet se:

Ngastra kadastrale me Nr. **00268-1**, nga certifikata nr. **08-942/03-0043062/24**, e datës 22.02.2024, te vendi i quajtur **Krlinski Dubovi**, toka Pyjore, Mal i Klasës 5, pronë **Komuna e Rahovec**, zona kadastrale Hoçë e Madhe, është në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031, me Nr. 182/24 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, të datës 30.01.2024, kjo zonë ka destinim Tregtar – 3.Prodhim tretësor/ 31.Shërbime tregtare/ 311.Shërbim tregtar me shumicë dhe pakiicë.

Me respect!

U dergohet :

- Palës,
- Arkivit.





Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë me, Nr. Prot. 6457, të datës 4.11.2024, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2023, miraton këtë:

### V E N D I M

#### **Për ndarjen e pjesëve të parcelave për rirregullim të kufijve kadastralë**

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/0000, i datës 00.12.2023 dhe merret vendimi për ndarjen e pjesëve të parcelave për rirregullim të kufijve kadastralë në zonën kadastrale Kramovik dhe zonën kadastrale Petkoviç, për ndërtimin e Parkut Solar 100MW, si në vijim:
  - 1.1.** Pjesën e parcelës P-71510061-00185-0 në Zonën Kadastrale Petkoviç, në vendin e quajtur rudina-rudina, në posedim të: P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-RRUGËT;
  - 1.2.** Pjesën e parcelës P-71510061-01122-0 Zonën Kadastrale Petkoviç, në vendin e quajtur rudina-rudina, në posedim të: P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-RRUGËT;
  - 1.3.** Pjesën e parcelës P-71510061-01124-1 Zonën Kadastrale Petkoviç, në vendin e quajtur gradina-gradina, në posedim të: P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-RRUGËT;
  - 1.4.** Pjesën e parcelës P-71510061-01124-2 Zonën Kadastrale Petkoviç, në vendin e quajtur gradina-gradina, në posedim të: P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-RRUGËT; dhe
  - 1.5.** Pjesën e parcelës P-71510039-00760-1 Zonën Kadastrale Kramovik, në vendin e quajtur boka-grop, në posedim të: PRONË SHOQËRORE-RRUGËT; K.K.RAHOVEC.
- 2.** Parcelat e reja të cilat do të formohen, do të evidentohen në emër të Komunës së Rahovecit.
- 3.** Qëllimi i ndarjes së pjesëve të parcelave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është marrja e lejeve dhe e licencave përkatëse në organeve qendrore dhe lokale, për ndërtimin e parkut solar 100 MW nga "Lindja Solar L.L.C."
- 4.** Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë ndarjen e parcelave, kufizimin dhe regjistrimin në librat kadastralë.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr. \_\_\_/24  
Datë: 22.11.2024

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Komuna e Rahovecit**  
Opština Orahovec / Municipality of Rahovec  
